



**4th International Conference on Linguistics,
Literature and Education**

BOOK OF PROCEEDINGS

Organized by:



In partnership with:



**September 7 2019 @AAB College
Pristina, Republic of Kosovo**

ICLLE 2019

The fourth conference on Linguistics, Literature and Education 2019 organised by AAB College in partnership with the Pedagogical University of Cracow, Poland, Aleksander Moisiu University, Durrës, Albania, and the University "St. Kliment Ohridski" in Bitola, North Macedonia, brought together renowned researchers, scholars and practitioners in the field of Linguistics, Literature and Education with the aim of presenting their academic achievements as well as discussing and exchanging a multitude of issues related to the relevant topics of the conference. In recent years, AAB College has transformed itself into a center of research and an important scientific setting for various foreign and Albanian linguists and scholars, who are building bridges of cooperation in the region and beyond. Thus far, various linguistic topics with different thematic foci, and methodological approaches have been exchanged, ranging from the study of language in educational contexts to the social role of English, Albanian and literary studies, discourse analysis, pragmatics etc. This year's conference will serve as a channel of research exchange for a broader scope of different disciplines including and not limited to linguistics, literary studies, translation studies, etc.

The topics:

- Applied Linguistics
- English and American Literature
- English for Specific Purposes
- Sociolinguistics
- Translation Studies
- Linguistic Policy
- The Importance of Professional Education
- Higher Education: Challenges and Issues
- Language curriculum Development
- Language testing and Assessment
- TESOL / TESL / TEFL
- Early Childhood Education
- Basic Education and Curricula etc.

Scientific committee

- Assist. Prof. Dr. Marika Butskhrikidze, AAB College
- Prof. Dr. Lulzim Tafa, AAB College, Rector
- Assist. Prof. Dr. Tomczyk Lukasz, Pedagogical University of Cracow
- Assoc. Prof. Dr. Griselda Abazi, “Aleksander Moisiu” University, Durres – UAMD
- Assist. Prof. Dr. Bisera Kostadinovska-Stojchevska, St. Clement of Ohridski University of Bitola
- Dr. Michał Szyszka, WSB University
- Assist. Prof. Dr. Silvana Neshkovska, St. Clement of Ohridski University of Bitola
- Assoc. Prof. Dr. Violeta Janusheva, St. Clement of Ohridski University of Bitola
- Dr. Anita Muho, “Aleksander Moisiu” University, Durres - UAMD
- Assist. Prof. Dr. Hasan Saliu, AAB College
- Dr. Aida Alla, AAB College
- Assoc. Prof. Dr. Mirvan Xhemaili, AAB College
- Assist. Prof. Dr. Venera Llunji, AAB College
- Assist. Prof. Dr. Hysen Kasumi, AAB College

Organizing Committee

- Dr. Aida Alla
- Prof. Assist. Dr. Hasan Saliu
- Prof. Asisst. Dr. Hysen Kasumi

Table of Contents

Punimet interaktive në klasë me nxënës dhe ndikimi i tyre në ngritjen e rezultateve të të nxënit Arjana Zhubi	7
Sfidat e mentorimit në aftësimin praktik të mësuesve të rinj Artur Prifti, Silvi Hoxha	21
Shprehësia në “Lahutën e Malcis” Bedri Zyberaj.....	31
Personazhi i femrës në librin “Prijësa e komiteve” të Sulejman Krasniqit Besa Hoxha Beqiri.....	41
The Role of the Teacher in Developing Communicative Skills Among Young Learners of English as a Foreign Language Blerim Sherifi	53
Loja dhe ndikimi i saj te fëmijët parashkollorë (5-6 vjeçarë).....	61
Dardane Qarri Qela, Tringa Dedi	61
Hello Student, Where Are Your Books? Diedon Dorambari	71
Word Order in English and Albanian Declarative Sentences Erjon Agolli	93
Data Visualization in Teaching - Learning Motivation and Innovation Fitnete Martinaj	103
The Impact of Using English Words into the Albanian Language Flora Maliqi	113
The Influence of Concept Mapping on EFL Students’ Learning Outcome Lela Ivanovska	121
Challenges of Teaching the English Language for Information Technology (IT) Miranda Enesi, Ekatarina Strati	133
Using Context in Teaching English Idioms to Albanian Students at the University Level in Kosovo Mirsad Suhodolli	141
Identiteti kombëtar dhe identiteti klasor në poezinë bashkëkohore shqipe Sali Bytyçi	149

Teachers` Perspectives in Applying Formative Assessment in English as a Foreign Language in Writing Skills	
Samir Skenderaj, Hysen Kasumi	159
Problemi i filozofisë së personazhit në <i>Nga jeta në jetë - Pse dhe Vuajtjet e djaloshit Verter</i>	
Selim Sylejmani	167
Is Being Bilingual Worth it?	
Sijeta Braha	181
Understanding the Factors which Affect Learning, Promote a Safe Environment on Students with Specific Learning Difficulties	
Alma Lama	195

Punimet interaktive në klasë me nxënës dhe ndikimi i tyre në ngritjen e rezultateve të të nxënës

Arjana Zhubi, PhD

Universiteti i Prishtinës
ariazhubi@hotmail.com

Abstrakt

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të fitojmë ide të reja krijuese nga nxënësit, rreth ndikimit dhe aplikimit të punimeve interaktive për të ngritur rezultatet e të nxënës, duke e bërë mësimin më tërheqës dhe më praktik në klasat tona. Në këtë hulumtim marrin pjesë 50 nxënës nga dy klasa të 5-ta të shkollës fillore “Mustafa Bakija” në Gjakovë, shkollë në të cilën punoj si mësimdhënëse e programit fillor. Dizajni i hulumtimit është cilësor dhe sasior. Si metodë sasiore e hulumtimit është përdorur kuazi-eksperimenti, ku funksionojnë dy grupe: grupi eksperimental dhe grupi i kontrollit, të përfshirë nga 25 nxënës. Me anë të metodës cilësore është vëzhguar puna e nxënësve përmes punimeve interaktive në klasë nga një listë kontrolli. Instrument është përdorur pyetësi me nxënës, i cili u realizua pas përfundimit të aplikimit me punimet interaktive, për të kuptuar qëndrimet e nxënësve në lidhje me aplikimin e kësaj forme të re në klasat tona në ngritjen e rezultateve të të nxënës. Analiza e të dhënave nga pyetësi me nxënës është bërë përmes programit SPSS. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se aplikimi i punimeve interaktive ndikon drejtpërdrejtë në ngritjen e rezultateve të të nxënës të nxënësve. Punimet interaktive në klasë dëshmuar ndikimin e të mësuarit me stile të ndryshme të të nxënës dhe zhvillimin e inteligjencave të shumëfishta. Përmes këtij hulumtimi u tregua se punimet interaktive në klasë mund të ndihmojnë nxënësit të bëhen të organizuar, të arrijnë sukses më të lartë në mësim dhe të nxënës të jetë më afatgjatë. Hulumtimi është realizuar në periudhë tremujore, gjatë vitit shkollor 2017/2018.

Fjalë kyç: *punime interaktive, rezultate të të nxënës, nxënës kreativ, stilet e të nxënës, inteligjenca të shumëfishta*

Hyrje

Fokusi kryesor për të gjithë mësimdhënësit është se si të arrijmë rezultate sa më të larta në procesin mësimor. Gjatë tërë mësimdhënies mundohemi të zhvillojmë të menduarit kritik te nxënësit. Por nuk mjaftojnë vetëm strategjitë që zbatojmë në klasë. Të nxënit aktiv është kthyer në qëllim të sistemit arsimor dhe novator në vendet e zhvilluara (Wist, 2006), sepse zhvillimet dhe ndryshimet që po ndodhin në globin tokësor, kërkojnë individë të aftë dhe krijues për të përballur sfidat globale. Punimet interaktive në klasë kanë të bëjë me aftësinë e një nxënësi ose grupi për të ndërtuar e imagjinuar rreth temave të caktuara, për të vënë një koncept, një ide apo për të zgjidhur në mënyrë origjinale një problem të caktuar (Macarelli, 2010). Derisa punimet interaktive po popullarizohen gjithandej nëpër shkollat ndërkombëtare, është e rëndësishme të kuptohet se hulumtimi shkencor po mbështet përdorimin e tyre, por më shumë në aspektin teorik se sa praktik, pra ende nuk janë mbledhur dëshmi sa duhet (Madden, 2001). Prandaj ekziston nevoja që kërkimet të mbledhen dhe të sintetizohen, për të siguruar mbështetje dhe dëshmi për përdorimin e punimeve interaktive, si mjete efektive gjatë mësimnxënies. Përveç kësaj, punimet interaktive duhet të shpjegohen, në mënyrë që të gjithë nxënësit, mësimdhënësit dhe administratorët të kuptojnë aplikimin dhe organizimin e tyre (Wist, 2006). Mësimdhënësve do t'u rikujtojmë vlerën e stileve të të nxënit, duke inkorporuar inteligjencat e shumëfishta në mësimdhënie, si mjet organizativ në klasë dhe inkurajim për përdorimin e strategjive dhe metodave të ndryshme të mësimdhënies. Për shkak se nxënësit kanë stile të ndryshme të të mësuarit, mësimdhënësi duhet të akomodojë këto aftësi, në mënyrë që të planifikojë dhe të kryejë me sukses detyrat për të vlerësuar se çfarë kanë mësuar nxënësit (Manner, 2001). Gjithashtu, për nxënësit ofron një mënyrë të re dhe atraktive, se si të organizojnë informacionet në klasat e tyre përmes marrjes së shënimeve, duke i përpunuar sipas dëshirës personale të tyre dhe punimeve interaktive. Nxënësit do të jenë në gjendje të inkorporojnë mësimet dhe materialet e tyre në formë interaktive për të ngritur rezultatet e të nxënit në çdo fushë mësimore. Po ashtu, duhet të kuptojnë rëndësinë e angazhimit të vazhdueshëm në aktivitetet sfiduese gjatë punimeve interaktive (Langberg, J. M. & Epstein, J. N., 2008). Arritja e këtyre rezultateve është problem brengosës jo vetëm për mësimdhënësit, por edhe për nxënësit në të njëjtën kohë. Kjo situatë ndodh për disa arsye:

Tekstet mësimore janë të stërngarkuara me informacione dhe shifra, janë monotone, joatraktive dhe aspak të përpunuara nga ana didaktike, sidomos librat në lëndën *Njeriu dhe natyra*. Arsye tjetër është pamundësia e shfrytëzimit të teknologjisë, pasi që ajo nuk është e mjaftueshme në

shkollat tona, për të vizualizuar dhe për ta bërë më tërheqës mësimin për nxënësit. Po ashtu, mungesa e hulumtimit dhe e kreativitetit të nxënësve në mësim, marrja e shënimeve pa udhëzime të mirëfillta të mësimdhënësve për t'i organizuar ato, mospërshtatja e mësimdhënies me inteligjencat dhe stilet e të nxënësve, janë disa nga shqetësimet e mësimdhënësve në procesin mësimor. Për ta përmirësuar këtë gjendje të nxënësve, kam menduar të gjej formë tjetër, një praktikë të mësimdhënësve ndërkombëtarë, një mjet mësimor efektiv. Pikërisht, kam zgjedhur lëndën *Njeriu dhe natyra*, në të cilën, përmes punimeve interaktive në fletoret e tyre, nxënësit punojnë në klasë, marrin informacione elementare, duke vazhduar edhe në shtëpi, për shkak të kohës së shkurtër të orës mësimore dhe kushteve jo të mira nëpër klasat tona për punë interaktive.

Objektivat e këtij hulumtimi janë: të vërehet efekti i punës në mënyrën e të nxënësve - se si ajo u mundëson atyre të bëhen hulumtues, kritikë, kreativë, të nxënë në mënyrën e tyre më të mirë, në stilin e tyre të të nxënësve, të nxjerrin në pah inteligjencat e tyre, të mësojnë të marrin shënimet e duhura dhe në mënyrë të organizuar gjatë marrjes së informacioneve të reja dhe, çka është më e rëndësishmja, të gjitha këto t'i arrijnë duke aplikuar punimet interaktive. Prandaj, mësimdhënësit duhet të angazhohen që të gjejnë mjete, strategji, aktivitete e detyra të ndryshme të llojit të tillë, si fletorja me punime interaktive, e cila u ndihmon nxënësve të kuptojnë dhe ndërlidhin konceptet, t'i shpjegojnë ato me fjalët e tyre, në mënyrën e tyre, t'i aplikojnë njohuritë e marra në një kontekst tjetër, të bëjnë krahasime ose analogji (Perkins). Nëpërmjet këtij hulumtimi u dëshmuar se punimet interaktive, si mjete mësimore efektive, ndikojnë dukshëm në ngritjen e rezultateve të të nxënësve në çdo fushë mësimore, u përshtaten stileve dhe inteligjencave të ndryshme, i mësojnë nxënësit të jenë më të organizuar në marrjen e shënimeve, i bëjnë më kreativë, më hulumtues dhe më kritikë në përzgjedhjen e informacioneve (Wilson, 2015). Kështu, mësimdhënësit me përdorimin e fletoreve interaktive, do të jenë në gjendje të inkorporojnë mësimet dhe materialet e tyre përmes punimeve interaktive, për të rritur motivimin dhe arritjet e nxënësve.

Shqyrtimi i literaturës

Për punimet interaktive në klasë, me nxënës, kam mësuar duke hulumtuar eksperiencat dhe praktikat e mësimdhënësve të ndryshëm ndërkombëtarë. Janë fletore të formatit A4, me kopertina të trasha, në të cilat nxënësit mbledhin dhe përpunojnë të dhënat dhe informacionet. Është një mjet mësimor, që bazohet në hulumtimin, mbledhjen dhe përpunimin e

informacioneve e koncepteve në mënyrë kreative. Punimet interaktive në fletoret e tyre, nxënësit i përdorin për të bërë lidhjet e para me njohuritë e reja, për të rishikuar idetë e tyre, për të thelluar kuptimin përmes informacioneve të shumta që na rrethojnë. Është kulminacioni i punës së nxënësit brenda një periudhe kohore apo brenda vitit, që i tregon të dyja: edhe atë që është nxënë, edhe reflektimet mbi njohuritë e marra (Annis, 2001). Punimet në fletoren interaktive ndihmojnë nxënësit që t'i mbajnë mend dhe t'i rikujtojnë informacionet që iu nevojiten kur vlerësohen nga mësimdhënësi (Kiewra, 1985). Nxënësit do të shfrytëzojnë aftësitë e të menduarit kritik për të organizuar dhe procesuar informacionin. Si rezultat, ata mund të bëhen më kreativë, më të pavarur në përzgjedhjen e informacioneve dhe do ta zhvillojnë të kuptuarit e thellë rreth mësimëve që mësohen (Campbell, L., Campbell, B. & Dickinson, D., 2004). Ajo u jep mundësi nxënësve që ta personalizojnë informacionin dhe ta ndërlidhin me informacionet që veç i dinë përmes përdorimit të ilustrimeve, hartave të ndryshme tematike, pemës së mendjes, fotografive të ndryshme, skicave etj. Kështu, kur t'i lidhin ato ide, atëherë nxënësit do t'i shprehin me fjalët e tyre, me ç'rast nxënësit do të jenë në gjendje të bëjnë analogji dhe gjeneralizime rreth temës së dhënë (Perkins, 1991). Punimet interaktive krijohen kur nxënësit kombinojnë strategjitë e ndryshme të mësimdhënies, siç janë: shënimet, hartat e koncepteve, organizimi i ideve me teknika të ndryshme mësimore, hulumtimet dhe kreativitetin e tyre. Kjo u jep mundësi të mësojnë në mënyrën më të mirë të tyre (Young, 2003). Duke iu referuar atyre (Stickel, 2005), nxënësit mund të demonstrojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre më të mira në disa mënyra. Konkretisht, këtë e shohim në dy aspekte: në përfitimin e njohurive të reja dhe në demonstrimin e suksesshëm të tyre. Pra, përmes punimeve interaktive, nxënësi konsrtukton njohuritë e tij dhe bën lidhjen mes informacioneve në një tërësi. Kjo ka të bëjë me zhvillimin e niveleve të larta të të menduarit kritik dhe me qasjen konstruktiviste (Caine, R. M., Caine, G., McClintic, C. & Klimek, K., 2005).

Punimet interaktive përmbajnë informacione, nëpër të cilat “udhëtohet” së bashku për të mësuar rreth një teme të caktuar; të cilat përzgjidhen nga vetë nxënësi, duke i ilustruar ato me fotografi, vizatime, harta, tabela e grafikone, duke përfshirë edhe pyetje e kuriozitete përkatëse (Young, 2003). Kjo i shtyn nxënësit që të hulumtojnë në literaturë, revista, libra të ndryshëm; ta shfrytëzojnë kompjuterin dhe internetin për informacione shtesë, gjë që u lejon atyre të zbulojnë kreativitetin e brendshëm, nxit mendimin kritik, jep mundësi që të zgjidhin problem, të parashtrojnë pyetje, të shprehin në stilin e tyre dhe të zhvillojnë

inteligjencën (Wist, 2006). Aplikimi i punimeve interaktive ka treguar se ndihmon në angazhimin e nxënësve gjatë procesit të të nxënës. Nxënësit kanë përqafuar idenë e fletoreve interaktive dhe mësimdhënësit në hulumtime të shqyrtuara kanë raportuar që, për shkak se kjo fletore inkurajon një shumëllojshmëri të formave të shprehjes, ka më shumë përfshirje, interesim, mësim dhe organizim më të mirë të nxënësve. Punimet interaktive janë treguar të suksesshme për sa i përket angazhimit të nxënësve në klasë, sepse nxënësit bëhen pjesëmarrës aktivë në mësimin e tyre. Nxënësit inkurajohen të përdorin inteligjencat e shumëfishta të tyre, të organizohen sistematikisht gjatë të nxënës dhe fletoret me punimet interaktive bëhen portofol i të nxënës individual (Bower, B. & Lobdell, J., 2005).

Punimet interaktive largojnë strategjitë tradicionale të marrjes së shënimeve dhe e bëjnë nxënësin më aktiv gjatë procesit të marrjes së shënimeve (Boylf, 2001). Shumica e mësimeve përfshijnë problem praktike të udhëzuara, të cilat i lejojnë nxënësit të jenë nxënës aktivë për të zgjidhur problemet, ndërkohë që udhëhiqen nga mësimdhënësi (Weishaar, 1999). Pasi nxënësit të marrin shënime për punimet e tyre interaktive, atëherë u jepet mundësia për të treguar atë që kanë mësuar duke shprehur mendimet, punën dhe proceset e të menduarit, kur ata përfundojnë shkrimet e tyre të pavarura (Ayati, 2006).

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të hulumtohet aplikimi i mjeteve të përshtatshme mësimore, siç janë punimet interaktive, si dhe ndikimi i tyre në ngritjen e rezultateve të të nxënës të nxënësit e shkollës fillore dhe, njëkohësisht, në theksimin e rolit të tyre si ndihmues të nxënësit për organizimin dhe sintetizimin e informacionit që iu është dhënë atyre në klasë.

Pyetja e hulumtimit:

Pyetja kryesore, në të cilën do të përgjigjet ky hulumtim, është:

- Si ndikon aplikimi i punimeve interaktive në ngritjen e rezultateve të të nxënës të nxënësit?

Për të gjetur përgjigjen e pyetjes kryesore, na kanë shërbyer edhe disa pyetje ndihmëse:

- A janë punimet interaktive mjete të dobishme në procesin mësimor?
- A nxisin kreativitetin e nxënësve këto punime interaktive?

- A përshtaten punimet interaktive për të gjitha stilet dhe inteligjencat e nxënësve?
- Cilat janë perceptimet e nxënësve për punimet interaktive?

Metodat

Metodologjia e përdorur është hulumtimi në veprim, metoda e kuazi-eksperimentit, si dhe instrumentet për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si: vëzhgimi i vazhdueshëm gjatë punës me punime interaktive, me anë të një liste kontrolli, para dhe pas testi.

Vëzhgimi i nxënësve na ka ndihmuar të vërejmë se si po përpunohen informacionet e reja, organizimi i tyre, niveli i mendimeve dhe i ideve, paraqitja vizuale dhe estetike e tyre, kreativiteti gjatë punimeve interaktive. Ndërsa, para dhe pastesti janë realizuar në fillim dhe në fund të periudhës së aplikimit me punimet interaktive. Me këtë rast është bërë krahasimi i rezultateve të dy testeve të realizuara, ku do të shihet edhe ndikimi i punimeve interaktive, por edhe krahasimi i rezultateve të nxënësve të grupit joeksperimental, me ata të cilët kanë aplikuar fletoren me punime interaktive, për të parë se sa është ndryshimi mes rezultateve të tyre. Participantë në këtë hulumtim janë 50 nxënësit e dy klasave të 5-ta të shkollës fillore “Mustafa Bakija”, ku edhe punoj: 25 nxënës (15 meshkuj dhe 10 femra) në grupin joeksperimental dhe po 25 nxënës (12 meshkuj dhe 13 femra) në grupin eksperimental. Mostra ka qenë e qëllimshme, pasi janë zgjedhur dy paralele të klasave të 5-ta, me numër të njëjtë të nxënësve.

Plani i veprimit, mbledhja e të dhënave, analiza dhe rezultatet

Hapi i parë: Përpilimi i një testi përmbledhës të njohurive nga lënda *Gjuhë shqipe*, me 10 pyetje, me anë të të cilit janë matur njohuritë e nxënësve të grupit eksperimental, para se të fillohet me aplikimin e punimeve interaktive.

Hapi i dytë: Dhënia e instruksioneve dhe e kriterëve për punime interaktive: qëllimin, formatin A4 e kopertinën, kurse dizajnin e punës e vendosin vetë nxënësit. Kriteret kanë qenë:

- Kjo fletore me punime interaktive i takon vetëm lëndës *Gjuha shqipe*;
- Fletorja duhet të përpunojë informacione dhe ide të ndryshme nga njësiti që mësohen në klasë, në mënyrën tuaj më të mirë të mundshme;

- Përveç tekstit shkollor, duhen përdorur edhe burime të tjera të informacioneve: revista, libra, faqe interneti;
- Çdo njësi duhet të ketë informacione, kuriozitete, pyetje dhe teknika të ndryshme të shënimeve sipas përzgjedhjes suaj;
- Që fletorja të jetë sa më e larmishme dhe më bindëse, duhet ta ilustroni me fotografi, harta adekuate sipas temës, grafikone, tabela, diagrame, harta konceptesh etj;
- Punimet interaktive duhet të punohen me materiale të ndryshme, si: letra me ngjyrë, letra ngjitëse, lapsa me ngjyra, fotografi të ndryshme etj.

Hapi i tretë: Vëzhgimi sistematik i punimeve me anë të listëkontrollit; dhënia e informatave kthyes rreth asaj se si kanë punuar, sa i kanë plotësuar kriteret, çfarë të përmirësojnë, si të vazhdojnë më tutje, duke shenjëzuar në një listë kontrolli përparimet e tyre.

Hapi i katërt: Zhvillimi i testit përmbledhës, pastesti, me pyetje të ngjashme, por kapitull me temë tjetër, të bazuar në nivelet e Taksonomisë së Bloom-it.

Listë kontrolli

Për të verifikuar se sa i kanë kuptuar instruksionet dhe sa i kanë përmbushur kriteret, kam përpiluar një listëkontrolli, për të evidentuar përparimin e tyre gjatë punimeve interaktive. Kontrollimi i punës së nxënësve është bërë 3 herë gjatë 8 javëve: javën e 2-të, të 5-të dhe të 8-të. Janë evidentuar: përpunimi i informacioneve, koherenca dhe kreativiteti, me shenjat përkatëse: Nivel i kënaqshëm (-), Nivel mesatar (+), Nivel i lartë (V). Në kontrollimin e parë, nxënësit nuk kanë punuar sipas instruksioneve të dhëna. Kishin mbushur fletoret me shumë tekst e informacione të shumta dhe ishin përqendruar më shumë se si të shkruajnë kuptimin e njësisë mësimore. Pas sqarimit shtesë, se si ata duhet të shkruajnë informacionet veç e veç, t'i ilustrojnë me fotografi, harta, vizatime, skica, grafikone, tabela, diagrame, tabela konceptesh, kuriozitete, të formulojnë pyetje etj., efekti filloi të vërehet menjëherë. Në kontrollimin e radhës, ata veç filluan ta shprehin veten në mënyrën që atyre u përshtatej më shumë dhe mundoheshin të sillnin sa më shumë informacione të reja rreth asaj që kishin hulumtuar, kuriozitete interesante etj., duke e bërë procesin e mësimnxënies sa më atraktiv dhe më të efektshëm. Nuk mungonin analizat e ndryshme, krahasimet mes temave, njësive, pyetjet logjike, sintetizimi i informacioneve dhe po ashtu ana kreative. Kjo ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin e mendimit kritik, sepse

ata, duke parë punën e njëri-tjetrit, shkëmbenin ide, informacione, kritika dhe vlerësonin edhe punën në grup. Njëkohësisht, edhe informatat kthye ndikonin në përmirësimin e punës së tyre interaktive, e cila i shtynte të eksploronin e të mësonin më shumë për temat e njëri-tjetrit. Kështu, në javën e pestë, nxënësit kanë ngritur dukshëm nivelin e punës së tyre, kurse në javën e fundit, kanë punuar në nivelin më të lartë të finalizimit të punës së tyre sipas listëkontrollit.

Tabela 1. Listëkontrolli gjatë vëzhgimit me punime interaktive

Emri i nx.	Kontrolli i parë Java e dytë			Kontrolli i dytë Java e pestë			Kontrolli i tretë Java e tetë		
	PI	KO	K	PI	KO	K	PI	KO	K
1. A. V.	-	+	V	+	+	V	+	V	V
2. A. K.	-	+	+	+	+	+	+	V	V
3. B. R.	-	-	+	-	-	+	+	+	V
4. B. U.	-	+	+	+	V	+	V	+	+
5. D. V.	+	-	+	V	+	+	V	V	V
6. D. R.	+	-	-	+	V	+	+	V	V
7. E. A.	+	-	+	V	+	V	V	V	V
8. E. H.	-	+	+	-	+	+	+	+	+
9. I. S.	-	-	+	-	-	+	+	+	+
10. J. M.	+	+	V	+	+	V	+	+	V
11. K. L.	-	+	+	V	+	+	V	V	V
12. L. O.	-	-	+	+	+	+	V	V	V
13. M. U.	-	-	+	+	+	+	+	V	V
14. N. ZH.	-	+	-	+	V	-	+	+	+
15. O. P.	+	-	V	+	+	V	V	V	V
16. O. H.	+	-	+	V	+	+	+	+	+
17. P. S.	+	-	V	+	+	V	+	V	V
18. R. A.	-	+	+	-	V	+	+	+	+
19. R. S.	-	+	+	+	+	+	+	+	+
20. T. R.	-	-	+	-	+	-	V	V	V
21. T. M.	-	-	+	+	-	+	V	V	V
22. U. M.	-	-	+	+	+	+	+	+	+
23. V. Q.	+	-	+	V	+	+	+	V	V
24. V. B.	+	+	V	+	V	V	V	V	V

25. Z. ZH.	+	-	-	+	+	+	V	V	V
------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Kodifikimi: Nivel i kënaqshëm (-); Nivel mesatar (+); Nivel i lartë (V)

Përpunimi i informacioneve: PI; koherenca: KO; kreativiteti (ana vizuale): K

Paratesti dhe pastesti - analiza dhe rezultate

Analizat e dhëna, para dhe pas testit, të realizuara në dy grupet (në atë eksperimental dhe joeksperimental) e shfaqin qartë efektin e punimeve interaktive. Shihet se grupi eksperimental ka treguar rezultate të përafërta me grupin joeksperimental të nxënësve në pikët e arritura në paratest, i cili është realizuar para se të aplikohen punimet interaktive. Por, vërehet qartë se në pastest, grupi që ka aplikuar punimet interaktive ka treguar rezultate dukshëm më të larta, se grupi i cili nuk është përfshirë në eksperiment.

Në tabëlën 2 mund të vërehet se të gjithë nxënësit kanë ngritur rezultatet, përkatësisht pikët e tyre të testit, ku dallimi mes pikëve të paratestit me pastestin ka qenë nga +2 pikë deri në atë me sinjifikanten, deri 22 pikë më shumë. Kjo tregon se punimet interaktive kanë ngritur rezultatin e të nxënësve, bashkëpunimin mes nxënësve, hulumtimin e informacioneve sipas stileve të ndryshme të të nxënësve, zhvillimin e mendimit kritik dhe zhvillimin e kreativitetit.

Tabela 2. Rezultatet e paratestit dhe të pastestit të nxënësve që kanë aplikuar punimet interaktive (grupi eksperimental)

Emri i nx.	Notat e testit		Pikët e testit		Ndryshimi në rezultat
	Testi 1	Testi 2	Testi 2	Testi 2	T2 – T1
1. A. V.	2	4	28	41	+13
2. A. K.	5	5	45	50	+5
3. B. R.	5	5	46	48	+2
4. B. U.	4	5	42	48	+6
5. D. V.	5	5	45	49	+4
6. D. R.	4	5	40	47	+7
7. E. A.	3	5	31	45	+14
8. E. H.	4	5	41	49	+8
9. I. S.	3	4	32	43	+11

10. J. M.	4	5	41	49	+8
11. K. L.	4	5	43	48	+5
12. L. O.	4	5	40	48	+8
13. M. U.	5	5	42	47	+5
14. N. ZH.	3	5	31	43	+12
15. O. P.	5	5	43	49	+6
16. O. H.	4	5	39	48	+9
17. P. S.	5	5	45	49	+4
18. R. A.	3	5	33	45	+12
19. R. S.	2	4	23	40	+17
20. T. R.	4	5	40	48	+8
21. T. M.	1	2	17	25	+8
22. U. M.	2	4	26	42	+16
23. V. Q.	1	3	15	35	+20
24. V. B.	1	3	9	31	+22
25. Z.ZH.	3	5	36	46	+10
Mesatarja	3.44	4.56	34.92	44.52	9.6

Të njëjtën gjë nuk e kanë treguar të dhënat e paratestit dhe të pastestit të grupit tjetër joeksperimental, te i cili nuk janë aplikuar punimet interaktive. Nga tabela 3 vërejmë se rezultatet e nxënësve të këtij grupi dallojnë nga grupi eksperimental, pasi ka ulje të notave, përkatësisht pikëve të testit të dytë në krahasim me të parin (deri -12 pikë) ose ngritje josingifikante te nxënësit më të mirë (maksimumi + 12 pikë).

Kur i krahasojmë mesataret e rezultateve të të dy grupet, shohim dallimin prej 7.25 pikësh më shumë të grupit të nxënësve që kanë përdorur punimet interaktive e që mesataren e ngritjes së pikëve e kanë prej 9.6 pikëve, kurse grupi tjetër arriti një mesatare prej 2.36. Nëse i krahasojmë notat, mesatarja e grupit eksperimental është ngritur për 1.4 ose 0.96 të notës mesatare, ndërsa e atij joeksperimental vetëm 0.44.

Tabela 3. Rezultatet e paratestit dhe të pastestit të nxënësve që NUK KANË aplikuar punimet interaktive (grupi joeksperimental)

Emri i nx.	Notat e testit		Pikët e testit		Ndryshimi në rezultat
	Testi 1	Testi 2	Testi 2	Testi 2	T2 – T1
1. A. I.	2	3	26	30	+4
2. A. M.	2	2	23	26	+6
3. B. B.	5	5	47	45	-2
4. D. R.	2	3	28	31	+3
5. D. H.	4	3	41	33	-8
6. E. K.	4	3	43	39	+4
7. E. Q.	1	2	17	28	+9
8. I. J.	4	5	43	48	+5
9. J. P.	5	4	42	39	+2
10. J. L.	4	5	40	47	+7
11. K. S.	4	2	43	25	+5
12. L. Ll.	3	3	34	31	-12
13. M. O.	3	3	34	35	+1
14. N. R.	4	2	41	26	-3
15. O. V.	1	2	16	20	+5
16. P. K.	2	3	24	31	-2
17. P. S.	3	4	35	39	+4
18. R. I.	3	4	39	45	+6
19. R. H.	2	3	28	35	+12
20. T. Ll.	4	2	41	29	-6
21. T. M.	1	3	17	31	+3
22. U. P.	5	4	43	39	+1
23. U. H.	4	3	42	37	+2
24. V. D.	4	3	40	36	+6
25. V. Z.	4	4	38	42	+4
Mesatarja	3.16	3.6	34.84	37.2	+2.36

Përfundime dhe rekomandime

Në bazë të këtij hulumtimi dhe rezultateve të nxjerra, mund të përfundojmë se:

- Është vërtetuar se rezultatet e hulumtimit përputhen me ato ndërkombëtare dhe se nuk ka ndonjë pengesë për sa i përket kontekstit se ku aplikohen punimet interaktive.
- Punimet interaktive kanë ndikuar pozitivisht në të gjitha aspektet e fushave mësimore, duke përmirësuar dukshëm rezultatet e të nxënësve të koncepteve të reja të nxënësve të klasave V.
- Punimet interaktive u mundësojnë nxënësve të kenë lirinë e përzgjedhjes së informacioneve, lirinë për t'u shprehur në stilin e tyre të të nxënësve, si dhe të shprehin inteligjencat e tyre.
- Përmes punimeve interaktive nxënësve nxiten të jenë më kreativë dhe të krijojnë një stil të veçantë të paraqitjes së informacioneve.
- Nxënësve organizojnë dukshëm më mirë shënimet e tyre, duke i përpunuar e jo vetëm duke i përshkruar si përpara.
- Punimet interaktive punohen me dëshirë nga nxënësve dhe ata preferojnë aplikimin e tyre edhe në lëndët tjera.
- Është më e duhur që të punohet së pari në klasë gjatë realizimit të orës, e pastaj të reflektohet dhe të punohet me informata dhe material shtesë në shtëpi. Në këtë mënyrë, efekti i punimeve interaktive do të jetë më i fuqishëm.

Si rezultat i shqyrtimit gjatë këtij hulumtimi dhe përvojës sime gjatë aplikimit të punimeve interaktive, mësimdhënësve do t'u rekomandoja që:

- Të aplikojnë punimet interaktive në të gjitha lëndët, sepse është një mjet mësimor që lehtëson të nxënësve aktiv të nxënësve.
- Të inkurajojnë nxënësve të hulumtojnë informacione të reja jashtë librit të lëndës përkatëse dhe t'i sjellin ato në mënyrën më të mirë të mundshme përmes punimeve interaktive në fletoret personale.
- T'u japin mundësi nxënësve që të shprehen në stilin e tyre të të nxënësve.
- Të vlerësojnë punimet interaktive në bazë të kriterëve të caktuar që në fillim.
- Të inkurajojnë nxënësve që të mos kopjojnë punën e njëri-tjetrit, por të jetë puna origjinale e tyre.
- Të udhëzojnë vazhdimisht nxënësve që të përmirësojnë punën e tyre duke iu dhënë shembuj dhe informata kthyesë.

Referencat

- Annis, L. (2001). Effect of prefernce for assigned lecture notes on student achievement. *Journal of Educational Research*, 5(9), 179-181.
- Ayati, M. (2006). Interactive notebook strategies. *The education Journal*, III(11).
- Bower dhe Lobdell. (2005). *Social studies alive: Engaging diverse learners in the elementary classroom*. California: Teachers` Curriculum Institute.
- Boylf, J. (2001). *Enhancing the note-taking skills of studets with mild disabilities*. Intervention in School and Clinic.
- Caine, Caine, McClintic, Klimek, 2005. (n.d.). 12 Brain/mimd learning principlesin action: The fieldbook for making connections, teaching and the human brain. *Corwin Press*.
- Campbell, (2004); Dickinson, (2007). (n.d.). Teaching and learning through multiply intelligiences. *Pearson*.
- Kiewra, K. A. (1985). *Learning from alecture: An investigation of notetaking, review and attendance at lecture*. Human learning.
- Langberg, 2008; Epstein, (2007). (n.d.). Efficacy of an organization skills intervention toimprove the academic functionaing of students with attention-deficit/hyperactivity disorder. *School Psychology Quarterly*, 40-47.
- Macarelli, K. (2010). Teaching science with Interactive Notebooks. *The science in Education*, VI(15).
- Madden, M. (2001). Improving Student Achievement with Interactive Notebooks. *Elsevier*, 2(33).
- Manner, B. (2001). Learning styles and multiple intelligences in students: Getting the most of your students learning. *Journal of College Science Teachers*, 390-393.
- Perkins, D. (1991). *Educating for insight: Educational Leadership*.
- Perkins, D. (1991). Education for insight: Educational Leadership. *Elsevier*, VIII(23), 49.
- Stickel, S. (2005). Advences in brain research: Implications for educators. *Michigan Academy of Science, Arts & Letters*.
- Weinstein, C. and Mayer, R. (1986). The teaching of learning strategies. In W. d. Mayer. New York, Macmillan: ED Handbook on reserach on teching.
- Weishaar, M. K. (1999). Note-taking strategies for students. *Routledge*, VI(25).
- Wilson, K. E. (2015). The Impact Of Interactive Science Notebooks On The Middle School Students. *Springer*.

- Wist. (2006). Putting all together: Understanding the Research online interactive. *IV*(4), 36-44. doi: DOI: 10.1080/08886504.1999.10782269
- Wist. (2006a). *Putting all together: Understanding the Research Behind Interactive Notebooks*. Williamsburg: The collage of William and Mary.
- Young, J. (2003). Science interactive notebooks in the classroom. *Interactive classroom*, x(6).
- Young, J. (2003). Science interactive notebooks in the classroom. *Science Scope*.

Sfidat e mentorimit në aftësimin praktik të mësuesve të rinj

Artur Prifti, PhD & Silvi Hoxha, PhD

Universiteti Fan S. Noli, Korçë

arturprifti@rocketmail.com

Abstrakt

Përfshirja e profesionit të mësuesit në profesionet e rregulluara ka çuar në lindjen e sfidave që lidhen drejtpërdrejt me aftësimin praktik të studentëve të mësuesisë dhe mësuesve të rinj. Teoria dhe praktika në mësimdhënie i ka shoqëruar mësuesit gjatë gjithë formimit të tyre profesional dhe, që në hapat e para të mësimdhënies, janë njohur me mentorimin si një model që i pajis ata me praktika të suksesshme mësimdhënieje. Në këtë punim, “mentorimi” do të trajtohet në tri drejtime kryesore, të cilat lidhen me çështje teorike, kuadrin ligjor dhe sfidat e mentorimit sot, duke u përqendruar në përgatitjen e mësuesve mentorë dhe “mentorimin gjatë gjithë jetës”, si një koncept të ri. Synimi kryesor i këtij punimi lidhet me paraqitjen e gjendjes së zhvillimit të praktikave dhe vështirësitë e mësuesve mentorë. Metodologjia e nxjerrjes së të dhënave mbështetet në pyetësorë të zhvilluar me mësues mentorë, ndër ta edhe me mësues të trajnuar në këtë fushë. Të dhënat e nxjerra nga pyetësori me mësues mentorë, sidomos me mësuesit e trajnuar pranë Qendrës së Formimit të Vazhduar (QFV) të Universitetit “Fan S. Noli”, nga njëra anë do të shërbejnë për të pasqyruar gjendjen e zhvillimit të praktikave dhe, nga ana tjetër, do të përdoren për të vlerësuar modulën e trajnimit të ofruar nga QFV-ja.

Rezultatet e këtij punimi do të përdoren për të plotësuar sa më mirë kërkesat e mësuesve mentorë për trajnim dhe përmirësimin e vazhdueshëm të modulit të trajnimit për një “Life Long Mentoring”.

Fjalë kyç: praktikant, mentor, praktikë profesionale, praktikë mësimore, mentorim

Mentorimi dhe mësimdhënia

Të shumtë janë mësuesit që pësojnë atë që quhet “*reality shock*” në ditën e parë të punës, sepse nuk janë në gjendje të kryejnë lehtësisht detyrat e tyre. Përgatitja që marrin në shkollë, edhe pse një element shumë i rëndësishëm,

nuk arrin t'i përgatisë ata plotësisht për ditën e parë të punës, me një klasë të vërtetë nxënësish (Woolfolk, 2011).

Modeli i ri i përgatitjes praktike të mësuesve të rinj i referohet sistemit të mentorimit dhe bazohet në lidhjen e ngushtë ndërmjet një mësuesi mentor dhe një praktikanti. Në fillimin e viteve 90` për mentorimin e mësuesve të rinj nuk kishte një literaturë të mirëfilltë. Edhe ajo literaturë që ekzistonte ishte e shpërndarë, jo aq e njohur dhe në shumicën e rasteve hipotetike (Weimer, 1990). Sot gjen një numër të madh botimesh dhe dokumentesh që flasin për mentorin dhe mentorimin. Në shumë prej tyre gjen pikëpamje të ndryshme lidhur me konceptin e mentorimit. Shumica e këtyre pikëpamjeve e konsiderojnë mentorimin si një metodë për transferimin e njohurive praktike te mësuesi që trajnohet (Markja, Koncepti i mentorit, 2008).

Zanafilla e mentorimit mendohet të ketë prejardhje që nga koha e lashtë, më konkretisht që nga Greqia Antike. Mentori, shoku dhe këshilltari i Odisesë, u bë mbrojtës i djalit të tij, Telemakut. Mentori është një mësues me përvojë, i cili mëson dhe udhëheq studentin mësues në procesin e përvetësimit të mësimdhënies (Musai, 2003). Ka mjaft përkufizime mbi mentorimin në mësimdhënie. Përkufizimet më poshtë janë pranuar gjerësisht dhe cituar në (Husain, 2009) mbi mentorimin. Këto përkufizime pasqyrojnë ide të ndryshme mbi mentorimin dhe, në njëfarë mënyre, kapin thelbin dhe natyrën e tij:

- "Mentorimi shihet si një proces ku këshilluesi dhe stazhieri punojnë së bashku për të zbuluar dhe zhvilluar aftësitë e këtij të fundit".
- "Mentorimi mund të përkufizohet si kontakt i dyanshëm afatgjatë, domethënës, si dhe i efektshëm në jetën dhe stilin e personit tjetër" *Shea (1997)*.
- "Mentorimi është një bashkëpunim i mirëmenduar i një personi me më tepër përvojë se personi tjetër, me qëllimin që personi me më pak përvojë të rrisë e të zhvillojë aftësitë e veta" *Murray (1991)*.
- *Mentor* është mësuesi i institucionit arsimor të praktikave profesionale, i cili drejton praktikën profesionale të një a më shumë praktikantëve që zhvillojnë praktikën në këtë institucion (MAS, 2011).

Nga të gjitha këto përkufizime, shkëmbimi i përvojës në marrëdhënien praktikant-mentor shihet si thelbësore.

Në një numër studimesh të Bruke, 1987; Levine, 1989; Huberman, 1992 etj., janë dalluar faza të ndryshme të zhvillimit profesional të mësuesit. Përgjatë këtij zhvillimi mund të dallohen fazat e mëposhtme:

- *Faza paraprofesionale*, është periudha e formimit dhe trajnimit fillestar e cila synon zhvillimin e kompetencave fillestare të mësuesit. (Kjo fazë përfshin aftësimin teorik dhe praktik në universitete);
- *Faza e stazhit*, është periudha e vitit të parë të punës, që ka si qëllim mbështetjen e mësuesit për të mbijetuar nën kushtet e reja dhe për të filluar zhvillimin e një identiteti profesional dhe një repertori veprimesh të përshtatshme për profesionin;
- *Faza e rritjes në profesion*, periudha mes vitit të dytë dhe të shtatë të punës, e cila fokusohet në ndihmën që i jepet mësuesit për të shtrirë dhe zgjeruar njohuritë bazë dhe gamën e veprimtarive;
- *Faza e riorientimit drejt vetes dhe profesionit*, që cilësohet si kriza e mesit të karrierës;
- *Faza e çlodhjes*, që i përgjigjet periudhës para daljes në pension.

Bazuar në fazat e mësipërme, procesi i mentorimit bashkëngjitet në të njëjtat linja me fazat e zhvillimit profesional të mësuesit, si një element i zbatimit praktik të mësimdhënies.

- Faza e “*mentorimit pedagogjik*”, lidhet me fazën paraprofesionale dhe i referohet *praktikës pedagogjike*, që është forma e parë dhe më e rëndësishmja, e cila e ka vendin dhe peshën specifike të saj në kurrikulën e formimit universitar e të interesuarve për t'u bërë mësues (IKAP, 2012).

Në këtë pikë duhet theksuar se zhvillimi profesional i mësuesve dhe i institucioneve (universiteteve dhe shkollave) duhet të ecë krah për krah. Njëra nuk bën dot pa tjetrën. Në qoftë se ka ekzistuar ndonjëherë ndonjë marrëdhënie plotësisht e kuptimshme simbioze, ajo është bashkëpunimi midis universiteteve dhe sistemeve shkollore në përgatitjen fillestare dhe të vazhdueshme të mësuesve...; ato kanë filluar të bashkëpunojnë gjithnjë e më shumë për të krijuar bashkësi më të fuqishme dhe të qëndrueshme për studentët e mësuesisë, mësuesit fillestarë, mësuesit me përvojë më të gjatë dhe profesorëve të universiteteve. Ky është një rast ku mund të arrihet “sinergjia”. Programet e përgatitjes së mësuesve, të cilat janë të hartuara mirë dhe që mbështeten te puna në shkolla, janë po aq me përfitim për mësuesit mentorë sa edhe për të rinjtë në profesion, për profesorët e universiteteve sa edhe për mësuesit e shkollave (Fullan, 2002).

- Faza e “*mentorimit profesional*”, lidhet me fazën e stazhit dhe i referohet *praktikës profesionale* që lidhet me pedagogjinë e përgjithshme, me didaktika të lëndëve, për të cilat studenti formohet (IKAP, 2012) dhe, sipas Rregullores “Për organizimin dhe

zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit” është ushtrimi i profesionit të mësuesit nga praktikanti, nën drejtimin e përgjegjësinë e mentorit që realizohet për të fituar të drejtën e hyrjes në Provimin e Shtetit, që ndryshe njihet edhe si “stazh”.

- “Një profesion nuk krijohet nga certifikatat dhe censurat, por nga ekzistenca e njohurive të mjaftueshme profesionale, ekzistenca për t’i përmirësuar ato, dhe nga një dëshirë e vërtetë e anëtarëve të këtij profesioni për të përmirësuar praktikën e tyre” (Stigler & Hiebert, 1999). Faza e “*mentorimit gjatë gjithë jetës*” lidhet me fazat e tjera dhe mund të shihet në dy drejtime:
 - Drejtimi i parë lidhet me rritjen profesionale të mësuesve nëpërmjet shembujve që merr nga kolegët këshilla nga mësues me më tepër përvojë.
 - Drejtimi i dytë lidhet me aftësimin profesional nëpërmjet trajnimeve të ndryshme që zhvillon mësuesi ku përfshihen edhe trajnime që lidhen drejtpërdrejt me mentorimin.

Në fazën e rritjes profesionale edhe më tej përfshihet edhe formimi i mësuesit mentor, pasi në këtë fazë mësuesi është i përgatitur profesionalisht për të qenë një mësues mentor. Kuadri ligjor¹ i kësaj fushe përcakton qartë rrugën që do të ndjekë një student i mësuesisë për të përmbushur fazat e zhvillimit të tij profesional. Në këtë kuadër, një student i mësuesisë, pasi ka kaluar fazën paraprofesionale dhe diplomimin, i nënshtrohet praktikës profesionale duke u udhëhequr nga një mësues mentor në përfundim të së cilës vlerësohet e gjithë veprimtaria e tij nëpërmjet dosjes së tij. Nga ana tjetër, edhe mësuesi mentor, që të jetë i tillë, duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, si dhe të zbatojë përgjegjësitë e tij si mentor. Praktika profesionale zhvillohet duke u bazuar në programin e praktikës profesionale, në të cilën përcaktohen në mënyrë të detajuar kompetencat që duhet të fitojë praktikanti në përfundim të saj dhe ofron një përmbledhje të procedurës së kontrollit dhe vlerësimit të tij.

¹ Ligji nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Rregullorja për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit. Programi i praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Metodologjia e studimit


Zhvillimit të praktikave përmes sistemit të mentorimit po i kushtohet rëndësi e veçantë, e mbështetur kjo edhe nga përcaktimet ligjore në fuqi. Si një proces bashkëpunimi mentor- praktikant, mentorimi në arsimin parauniversitar çdo ditë përballet me vështirësi të shumta që lidhen me çështje të ndryshme të procesit të zhvillimit të praktikave. Synimi kryesor i këtij punimi lidhet pikërisht me paraqitjen e gjendjes së zhvillimit të praktikave, sidomos me vështirësitë e mësuesve mentorë, për këtë arsye metodologjia e përdorur në këtë drejtim lidhet me përdorimin e pyetësorëve drejtuar mësuesve që kanë përvojë në fushën e mentorimit.

Pyetësi në fjalë, i hartuar në format elektronik², iu shpërnda 80 mësuesve të arsimit parauniversitar, kryesisht të qarkut të Korçës. Rreth 50% e tyre iu përgjigjën këtij pyetësi, nga të cilët 60% i përkasin arsimit fillor dhe pjesa tjetër profileve të tjera. Niveli i kualifikimit i të anketuarve i referohet kryesisht tri niveleve të fundit të kualifikimit³ (85%).

Në lidhje me njohuritë e mësuesve rreth procesit të zhvillimit të praktikave, mësuesit pranojnë se kanë njohuri të plota mbi mentorimin (rreth 60% e tyre), duke e përvetësuar këtë informacion në forma të ndryshme nëpërmjet dokumenteve zyrtare të dhëna nga drejtuesi i shkollës (43%), në mënyrë personale (35%) dhe pjesa tjetër, (22%) nëpërmjet trajnimeve dhe takimeve të ndryshme lidhur me këtë temë.

Pjesa më e madhe e të anketuarve kanë përvojë mentorimi me studentë, kryesisht me ata që zhvillojnë praktika pedagogjike gjatë formimit universitar dhe praktikantë që zhvillojnë praktikën 1-vjeçare.

Vlerësimi i mësimdhënies përmes sistemit të mentorimit,



përgjithësisht vlerësohet pozitiv nga rreth 22 % e mentorëve. Pjesa më e madhe e tyre (57%) pranojnë se një pjesë e ngarkesës mësimore i kalon praktikantit, por nga ana tjetër i rritet

ngarkesa në plotësimin e detyrave si mësues mentor, duke mos sjellë lehtësim të ngarkesës së tyre. Ky fakt përforcohet edhe nga vlerësimi që


²https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLScRNRGZaI9IIdyGFggHoSKDaqgCHe0uIraJUztBPNf2eq7Bw/viewform?usp=sf_link

³ Mësues i kualifikuar (5 vjet), mësues specialist (10 vjet), mësues mjeshtër (20 vjet)

ata bëjnë për ngarkesën që krijon procesi i mentorimit ku në të dyja rastet, si në ngarkesën, ashtu edhe në lehtësimin e punës së tij nga praktikanti, vlerësohet mesatarisht nga ata.


Bazuar në rregulloren për zhvillimin e praktikave profesionale, kriteret e të qenit mësues mentor lidhen me plotësimin e disa kriterëve bazë, si niveli i kualifikimit dhe trajnimi në atë fushë dhe i vetmi motivim për ata lidhet me uljen e ngarkesës, që në të vërtetë kompensohet me ngarkesën e mentorimit të praktikantit. Ideja e krijimit të një statusi të veçantë të mësuesit mentor mbështetet nga rreth 90% e të anketuarve, të cilët kërkojnë një certifikim dhe motivim të kësaj kategorie. Kjo çështje mund zgjidhet duke u përfshirë si “titull” në një nga nivelet e kualifikimit 10-20 vjeçar, duke qene se edhe përvoja në mësimdhënie është e konfirmuar. Me marrjen e titullit mentor të shtohet edhe motivimi financiar.

MËSUESIT MENTORË DUHET TË KENË STATUS TË VEÇANTË
(Të jenë të certifikuar dhe të motivohen financiarisht)



Ashtu siç u trajtua në pjesën teorike, mësimdhënia është një proces i vazhdueshëm që në çdo moment ka nevojë për informacione bashkëkohore dhe shembuj mësimdhëniesh të suksesshme. Mentorimi

MARRIN PËRVOJË NGA MËSUESIT E TJERË



gjatë gjithë jetës është një koncept i ri i trajtuar në këtë studim, për këtë arsye u përfshinë edhe elemente të vlerësimit të tij. Lidhur me rritjen profesionale të mësuesve nëpërmjet shembujve, 70% e mësuesve pranojnë se marrin nga përvoja e mësuesve të tjerë


në kolektiv, kryesisht shembuj të zbatimit të kurrikulës së re, metodave të mësimdhënies, plotësimit të dokumenteve, organizimin e punës, madje edhe elementë të mentorimit. Nga ana tjetër, në aftësimin profesional nëpërmjet trajnimeve të ndryshme, pothuajse të gjithë mësuesit kanë zhvilluar minimalisht një modul trajnimi në një nga fushat që ofron Qendra për Formimin e Vazhduar pranë Universitetit “Fan S. Noli” dhe rreth 40% e tyre janë trajnuar në modulën që lidhet me mentorimin.

Përgjithësisht, kjo qendër vlerësohet pozitivisht nga mësuesit, meqenëse ofron module nga të gjitha fushat duke plotësuar gjithë nevojat

e tyre. Kjo reflektohet edhe nga fakti se trajnimi i zhvilluar u shërbeu pothuajse të gjithë mësuesve të trajnuar. Në rastin e mësuesve që zhvilluan modulën e trajnimit, i cili lidhet me mentorimin nga bashkëbisedimet gjatë trajnimit, të gjithë mësuesit e kishin të nevojshëm trajnimin, pasi nuk e njihnin procesin e zhvillimit të praktikave dhe kuadrin ligjor.

Fakti që të gjithë mësuesit e kanë zhvilluar minimalisht një trajnim mund të shihet edhe si një detyrim ligjor, por nga anketimi rezulton se 91% e tyre kanë nevojë dhe do të zhvillojnë trajnime të tjera që lidhen me mentorimin, duke sugjeruar përqendrimin e tij në elemente që lidhen me përvoja të suksesshme të mentorimit, kuadrin ligjor, përgatitjen e dokumenteve, vlerësimin e praktikantit etj.

ZHVILLIMI I TRAJNIMEVE NË FUSHËN E MENTORIMIT



Përfundime dhe rekomandime

Aftësimi praktik i mësuesve të rinj është një proces dinamik, një marrëdhënie e vazhdueshme mentor-praktikant që përmban në vetvete sfida, të cilat duhet të përmbushen si nga mentorët, ashtu dhe nga praktikantët. Duke qenë se në këtë studim u trajtuan çështje që lidhen me mësuesit mentorë, është e rëndësishme të theksohen sfidat për të ardhmen, pasi është një proces që gjithmonë ka nevojë për përmirësim. Edhe pse në Shqipëri ka vite që është futur koncepti i zhvillimit të praktikave nëpërmjet mentorimit, njohja e mentorëve me dokumentet ligjore të kësaj fushe duhet të jetë sa më i rregullt dhe këtu është detyra e drejtuesit të shkollës që të njohë mësuesit me kuadrin ligjor dhe ndryshimet.

Praktika pedagogjike dhe praktika profesionale, edhe pse zhvillohen në faza të ndryshme dhe kanë kërkesa të ndryshme, janë dy terma të cilat përmbajnë në vetvete të njëjtin qëllim, për këtë arsye duhet të krijohet një linjë, një vazhdimësi ndërmjet tyre. Partneriteti Universitet – DAR⁴ duhet të përfshijë elemente të vazhdimësisë në zhvillimin e praktikave, gjithmonë i bazuar edhe në aktet ligjore, duke krijuar një proces të aftësimit praktik që përmban të njëjtën linjë apo program që në momentin e parë, kur kandidati për mësues zhvillon orën e parë të aftësimit praktik e derisa përfundon praktikën profesionale pas diplomimit.

⁴ Drejtoria Arsimore Rajonale.

Bazuar në dokumentet ligjore që lidhen me zhvillimin e praktikave⁵, mësuesi mentor nuk përcaktohet me një status të veçantë, por përcaktohen kriteret që duhet të përmbushë një mësues mentor. Në këtë pikë përmendet gjithashtu se mentori duhet të jetë i pajisur me certifikatën e mentorit (nëse është mundësuar ky certifikim). Në të vërtetë, certifikimi i mentorëve në arsimin parauniversitar nuk është mundësuar ende dhe formimi i mentorëve është bërë vetëm në kuadër trajnimesh të zhvilluara nga QFV-ja⁶ dhe qendra të tjera trajnimesh. Certifikimi i mentorëve, duke krijuar një status të veçantë të mbështetur në motivimin financiar, do të përmirësonte edhe më tej cilësinë e zhvillimit të praktikave.

Procesi i mentorimit është një proces që nuk duhet parë vetëm në kuadrin e formimit të mësuesve të rinj. Duke e parë në prizmin e formimit të vazhduar, mentorimi është një proces që fillon që në momentin e parë të formimit si mësues dhe vazhdon gjatë gjithë jetës profesionale. Marrja e përvojës nga mësues të tjerë më me përvojë është një formë e mentorimit që ndodh shpesh në shkolla, madje dhe vetë mësuesit e pranojnë këtë fakt.

Mësimdhënia ka hapësira ku çdo mësues mund të rritet profesionalisht, qoftë nëpërmjet modeleve të kolektivit, dëshirës personale, trajnimeve, dhe formave të tjera. I rëndësishëm është fakti që çdo institucion arsimor të ketë në kolektivin e vet mësues të rinj, të cilët marrin nga modelet më të mira të mësuesve të tjerë me përvojë, mësues që në çdo moment marrin pjesë në trajnime për t'u rritur profesionalisht, mësues mentorë të certifikuar që japin modelet më të mira për praktikantët dhe mund të mentorohen, mbi të gjitha mësues që kanë frymën e bashkëpunimit me qëllim të përbashkët rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

⁵ Rregullorja për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

⁶ Moduli i trajnimit mbi mentorimin, të ofruar nga Qendra për Formimin e Vazhduar në Universitetin "Fan S. Noli", Korçë.

Referencat

- AEDP. (1998). *Udhëzues i Praktikës Profesionale*. Tiranë: AEDP.
- Fullan, M. (2002). Aleancat Universitet - sistem shkollor. Në M. Fullan, *Forca e ndryshimit (Depërtim në thellësitë e reformës arsimore)* (fv. 137-138). Tiranë: Pegi.
- Husain, Z. (2009). *The good menthoring guide*. UK: Global Synergy Solutions.
- IKAP. (2012). Analiza e situatës aktuale për procesin e mentorimit. Në IKAP, *(Studim) Vlerësimi i cilësisë së shërbimit të mentorëve në zhvillimin e praktikave profesionale të mësuesve të rinj gjatë vitit mësimor 2011-2012*. Tiranë: IKAP.
- Markja, A. (2008). Në IKT, *Revista Pedagogjike*. Tiranë: ILAR.
- Markja, A. (2008). Koncepti i mentorit. Në I. i. Trajnimit, *Revista pedagogjike*. Tiranë: ILAR.
- MAS. (2011, Korrik 14). Organizimi dhe Zhvillimi i Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit. Tiranë, Tiranë, Republika e Shqipërisë.
- Musai, B. (2003). Shpjegim. Në B. Musai, *Metodologji e Mësimdhënies*. Tiranë: ALBGRAF.
- Stigler, J., & Hiebert, J. (1999). *The teaching gap*. New York: The Free Press.
- Weimer, M. (1990). *Improving college teaching: Strategies for developing instructional*. San Francisco: Jossey-Bass.
- Woolfolk, A. (2011). Teoritë e mësimdhënies. Në A. Woolfolk, *Psikologji Edukimi* (f. 9). Tiranë: CDE.

Shprehësia në “Lahutën e Malcis”

Bedri Zyberaj, MSc

Kolegji AAB

bedri.zyberaj@aab-edu.net

Abstrakt

Krijimtaria letrare e Gjergj Fishtës në përgjithësi, po sidomos vepra e tij epike “Lahuta e Malcis” shquhen me një shkallë të lartë shprehësie në kuadër të të cilës frymojnë, stili i lartë, ndjeshmëria e fortë dhe bukuria e thënies. Shprehësia si kategori estetike përfshin në vete gjithë teknikat e rrëfimit, metrikën e caktuar, figuracionin (figurat e diksionit, të kuptimit etj) që në veprën e At Gjergj Fishtës është mjaft i pasur dhe shumë i gjetur si edhe elemente të tjera të arkitekturës letrare. Në kuadër të kësaj teme do të ndriçohen shkurtimisht disa nga këto elemente dhe sidomos figurat letrare që e shquajnë shprehësinë e “Lahutës së Malcis” duke u ndalur më gjerësisht te arkaizmat që, sipas mendimit tim, paraqesin elementin më qenësor dhe mjaft të vlershme të gjuhës së këtij autori në përgjithësi. Pavarësisht se tema i referohet kryeveprës së Fishtës „Lahuta e Malcis”, kur të bëhet fjalë për arkaizmat do të bëj përpjekje që shembuj më pikantë të kësaj natyre t’i hulumtoj dhe t’i gjej edhe në veprat e tjera të këtij autori, pa e përjashtuar asnjërën nga gjinitë e saj: lirikën, dramatikën dhe satiriken e tij. Në përmbyllje do të përpiqem të nxjerr përfundimet më domethënëse mbi bazën e premisave të shtruuara dhe të analizuara në pjesën kryesore të punimit.

Fjalë kyç: At Gjergj Fishta, vepra, krijimtaria letrare, epika, lirika, gjuha, figurat, arkaizmat, letërsia popullore etj.

Hyrje

Për të arritur te thelbi i temës së menduar për këtë rast, së pari, vlerësoj se është e nevojshme për të dhënë një shpjegim të shkurtër teorik se cila është domethënia e nocionit *shprehësi* dhe ç’nënkuptojmë me këtë shprehje. *Shprehësia*, paraqet një veçori krijuese me anë të tingullit, të fjalës dhe të vargut apo të ndonjë copëze tjetër ligjerimore si diçka e pazakonshme në rrjedhën e ligjërit, me qëllim për të tërhequr vëmendjen dhe për të

ndikuar sa më efektshëm te receptuesi. Rrjedhimisht, *shprehësia* është një kategori e rëndësishme stilistike, me peshën e njëjtë, për mendimin tim, që ka shija si kategori estetike. Sipas Shefkije Islamajt, shprehësia “në planin gjuhësor, paraqet tërësinë e njësive formale, semantike, funksionale dhe kategoriale në raportet e tyre homogjene e heterogjene.” (Islamaj, 2012, p. 229) Duke studiuar këtë çështje, Xhevat Lloshi (1988: 18) konstaton se “shprehësia është mbështetje krijuese për stilin, por nuk është vetë stili”, për të vazhduar më tej se “stilistika e shprehësisë është mikrostilistika, studimi përgjithësues i njësive e i kategorive të veçanta lidhur me funksionet që mund të marrin gjatë përdorimit” (Lloshi, 1988, p. 18). Të gjitha këto kategori mund të klasifikohen në disa grupe të veçanta, të cilat prapëseprapë ngelen kategori stilistike dhe kanë disiplinat përkatëse që merren me studimin e tyre. Kështu, kemi fonostilistikën që merret me studimin e mjeteve fonetike; morfostilistikën që merret me studimin e mjeteve morfologjike; leksikostilistikën që studion leksikun; semantostilistikën që studion kuptimin e fjalëve dhe sintaksostilistikën që studion togfjalëshat e fjalive. Për të qenë krijuesi i suksesshëm në këtë plan, duhet t’i japë vetes liri për të operuar me tingujt, fjalët dhe njësitë e tjera ligjërimore e të mos bëhet rob i atij përdorimi të zakonshëm, që është shndërruar në rregull dhe është bërë natyrshëm e shprehjes së përditshme. Meqë, siç e thashë me lart, kategoritë e *shprehësisë* janë të shumta, në këtë rast do të ndalem vetëm te ato ndryshime apo modifikime që shkrimtari i ynë i traditës, At Gjergj Fishta, i ka shfrytëzuar në sferën e fonetikës dhe fonologjisë, duke u mbështetur gjithnjë në modelet e letërsisë sonë popullore, njohës i së cilës ka qenë si asnjë tjetër krijues.

Modifikimet leksikore në funksion të përftesave stilistike

Gjergj Fishta, siç është thënë dhe pranuar nga kritika dhe historia e letërsisë sonë, paraqet njërin ndër personalitetet më të veçanta dhe më origjinale të letërsisë sonë të traditës. Derisa për nga tematika, vepra e tij (pothuaj e tëra) është në vazhden e tematikës së veprave të rilindësve tanë (këtu bëjnë pjesë tema për historinë, për gjuhën, për trimërinë dhe virtytet e tjera shpirtërore të shqiptarëve në përgjithësi), për nga gjuha e përdorur ajo dallon dukshëm prej tyre. Derisa rilindësit, kur është në pyetje gjuha shqipe dhe leksiku i saj, na duket sikur kanë dashur me çdo kusht të na vënë në pah, jo vetëm pasurinë e kësaj gjuhe, por dhe aftësitë e mundësitë e saja të shumta për të operuar me fjalën, Fishta duket se ka një qasje tjetër. Ai sikur do të na tregojë dhe dëshmojë atë që ka arritur kjo gjuhë deri në kohën e tij. Pra, rilindësit kishin qëllim parësor për të dëshmuar atë se çfarë mund

të bëjë gjuha jonë, ndërsa autori i “Mrizit të Zanave”, i “Anzave të Parnasit” dhe sidomos i “Lahutës së Malcis”, duket se ka për qëllim që të vërë në pah thesarin e kësaj gjuhe, të cilën e kishte formuar dhe formësuar shekuj dhe epoka para tij. Me fjalë të tjera, ky sikur pikësynim ka të japë prova konkrete se çfarë ka bërë deri tani kjo gjuhë. Kjo, si duket, ka përcaktuar dhe atë veçantinë e veprës së këtij autori, që është vënë në pah nga studiues të ndryshëm, se në të u ka dhënë përparësi leksikut të deriatëhershëm dhe mjeteve për përftesa të atypëratyshme, pa treguar ndonjë tendencë për të krijuar fjalë të reja si shumica e rilindësve tanë. Pra, kur bëhet fjalë për leksikun dhe mjetet e tjera të shprehësisë, shikimi i Fishtës është i drejtuar dhe i përqendruar kah e shkuara, pothuaj tërësisht, ndryshe nga krijuesit tjerë që shikimin e tyre e kishin të përqendruar disi drejt horizontit të ardhmërisë.

Nëse veprën e Fishtës, në tërësinë e saj, e vështrojmë dhe e analizojmë nga këndvështrimi gjuhësor, atëherë vërejmë se ai është krijuar, që i jep vetes një liri të madhe për të bërë modifikimet e duhura, të cilat janë në funksion të fuqizimit të shprehësisë. Këto modifikime në veprën e tij i hasim si *zgjerime: jishte për ishte, heci për eci, hylli për ylli etj.; rrëgjime: llinë për latinë, kashaten për kafshatën, shekllit për shekullit etj.; zëvendësime: mizorre-mixore për mizore, bakti për bagëti, tyrani për tirani etj.; përkalime: dilli për dielli, niri për njeri etj.; dhe tejvendosje: ulan për luan, probatim për pobratim, pomendore për përmendore etj.* Të gjitha këto, pa dyshim se janë bërë për qëllime stilistike, sado që, siç ka vënë re dhe e ka theksuar me të drejtë studiuesja Islamaj, jo gjithëherë janë të motivueshme dhe funksionale, siç janë menduar nga ana e autorit. Vështruar nga këto aspekte, vepra e Gjergj Fishtës, si e asnjë krijuesi tjetër të letërsisë sonë të traditës, ofron një mundësi të madhe të analizës së shprehësisë. Por, nëse kështu mund të thuhet duke e krahasuar Fishtën me autorët e letërsisë sonë të traditës, kjo nuk vlen në rast se këtë gjë, krahasimin e krijimtarisë së tij, e bëjmë me letërsinë popullore apo letërsinë gojore, siç e quajmë ndryshe, të të gjithë hapësirës shqiptare që është kultivuar në të kaluarën e largët dhe të afërt. Modifikimet e tilla në letërsinë popullore janë pothuaj krejt të zakonshme dhe bëhen pa as më të voglin ngurrim. E njëjta gjë ndodh edhe me laboratorin krijues të Fishtës. Për të qenë shprehësia e tij sa më e fuqishme, që në fillim duhet ta them se, te Fishta, nuk mund të vërehet as më i vogli hezitim për përdorimin e formave e trajtave dialektore e nëndialektore, lokalizmave e arkaizmave që lexuesi i sotëm, pa konsultimin e fjalorëve të ndryshëm, e ka të pamundur që t'i kuptojë. P.sh.: përdorimi i trajtës së shkurtër të vetës së tretë të foljes jam= *ásht* / *â*, që është karakteristikë vetëm për dialektin e gegërishtes, si në

vargun “Anë e kand, Shqypni a ky vend” (Fishta, Lirika, 1997, p. 50) te *Mrizi i Zanave* apo te *Lahuta e Malcis*’

„Ka dal fjala nper Cetinë,
Se i Shkodranë ká rá n’Vraninë,
N’at Vraninë, po n’at rranzë suket
Thonë ka rá ‘i far Oso Kuket
Kaleshan e kime-zi
Gjak e zjarm a aj syni i ti; (Fishta, Lahuta e Malcis, 1997, p. 57)

Kategori të tjera shtesë me funksion stilistik, që në veprën e Fishtës i hasim bukur shpesh, janë edhe sintagmat e qëndrueshme, të cilat i merr të gatshme, si dhe barbarizmat e, ndonjëherë, edhe ndonjë varg të plotë të ndonjë gjuhe të huaj që, si të tilla, i përkasin fushës së sintaksostilistikës. Këtu unë do të veçoja vetëm dy fjalë, sa për ilustrim. “Trobojnica” dhe “kapica”, të cilat, sado që për nga origjina janë dy fjalë të huaja, në sajë të mjeshhtërisë së autorit janë përftesa stilistike që kanë një fuqi të jashtëzakonshme shprehësie. I tillë është edhe një mallkim, që e hasim të shprehur në gjuhën serbe që, në atë rast, vjen si klithmë e një luftëtari malazez (Vukotiq Mijos) drejtuar bashkëluftëtarit të vet Tvrđko Stanes, pasi që duke u gjendur në një atmosferë alarmante nga ato që ndodhin në situata luftimesh, kur mundesh nga kundërshtari dhe të vetmin shteg e ke atë që të shpie te vdekja. Për ta dhenë

*Shka ká thanë vall, Tvrđko Stana:
Halla, nánë, e hallallë, tatë!
Se mana, me ç ‘m’ duket mue,
Vshtirë se kthej un mâ n’at dhe:
N’ ‘shtek të vshtirë po kam qillue:
Me ksi trimash kurr s’jam pré!
Udri, Tvrđko, Bog te ubijo!
Me një zâ sa kaá n’gabzherr,
Mbrapa i vret Vukotiq Mijo
Kah lshon turrin nper një djerr” (Fishta, Lahuta e Malcis, 1997, p. 582)*

Ky varg, i shqiptuar në origjinal, shkon përtej stilit të shprehësisë, sepse në vete ka edhe atë vetinë që studiuesi Xhevat Lloshi e vlerëson si instrument “për t’iu imponuar vëmendjes” (Lloshi, 1988, p. 15), dhe në këtë rast ka të bëjë edhe me stilistikën e marrësit (dëgjuesit ose lexuesit), pasi që stili del

edhe si përshtypje. Në fakt këtu, përveç si stilema, këto shprehje fitojnë edhe ngjyrimet e reja stilistike, ngase një gjë të tillë ua dikton konotacioni stilistik. Përveç këtyre kategorive stilistike, shprehësia në veprën e Fishtës është sendërtuar edhe mbi bazën e modifikimeve fonologjike e morfologjike në frymën e folklorit të të gjithë hapësirës shqiptare dhe jo vetëm të atij të Veriut, siç mund të pretendojë ndokush. Një grup i veçantë fjalësh, që janë në funksion të fuqizimit të shprehësisë stilistike, por dhe në të njëjtën kohë bëhen pengesë për përthithjen e plotë estetike e pse jo edhe kuptimore të kësaj vepre nga ana e lexuesve të brezave të mëvonshëm, janë arkaizmat. Prandaj vepra e Fishtës, në përgjithësi, e “Lahuta e Malcis”, në veçanti, sot kuptohet me vështirësi dhe janë të paktë njerëzit e brezit tonë që mund ta kuptojnë në leximin e parë dhe të dytë. P.sh.: Cili prej nesh sot e di se çfarë është “carani” apo shprehjet “duka”, “degame” (përleshje, konflikt) etj..?!

Askush.

Po kuptimin e foljes “rrâ” me trajtat: “rrâj”, “rrâjn”, “kam/kem/kanë me rrâ” etj., që, sa herë më ka rënë ta dëgjoj, shqiptohet si „ra” gjë që është gabim, sepse folja “me rrâ” është krejt një fjalë tjetër nga ajo “me ra”. Me rrâ e ka kuptimin ‘me u lëshue me furi’ ose në gjuhën letrare ‘për t’u lëshuar furishëm’. Vargjet “Për Shqypni në luftë me rrâ/Me rrâ n’luftë me kraj e mbret” (Fishta, Lirika, 1997, p. 51) nuk e kanë kuptimin për të rënë në luftë, që do të thotë për të vdekur, siç e kam dëgjuar edhe nga aktorët më me nam ta shqiptojnë këtë fjalë, kur e recitojnë poezinë e Fishtës, por për t’u lëshuar në fushë të mejdanit, në arenë të luftës (siç lëshohet nga shpati orte ku i borës), për të luftuar për Shqipërinë apo në rastin tjetër, që e hasim te Kanga e 3-të e “Lahutes së Malcis”:

„Njashtë turr për derë t’kaushës

Djelmt e Osos rrâjn drejt fushes

Ku kisht’ krisë e zezë potera

Motra e Avdis ku kjate e mjera” (Fishta, Lahuta e Malcis, 1997, p. 43)

Fishta dhe folklori shqiptar

Në kritikën tonë është një konstatim mbizotërues se vepra e Fishtës është krijuar nën tryninë e ndikimit të folklorit të Veriut, njohës i mirë i të cilit duket se ka qenë ai. Në sajë të kësaj dhe sipas modelit të krijimtarisë popullore, Fishta i jep vetes të drejtë që të operojë me fjalët (fonetikisht e morfologjikisht) sipas modelit të lirë të krijesit anonim të letërsisë sonë

popullore. Kur them të letërsisë sonë popullore, atëherë kam parasysh gjithë shtrirjen gjeografike të kësaj letërsie dhe jo vetëm atë të veriut.

Duke i bërë një vështrim këtij aspekti, studiuesi i folklorit prof.. Dr Enver Mehmeti, me të drejtë ka konstatuar se Fishta, “epopenë ‘*Lahuta e Malcis*’ e krijoi duke u mbështetur në poetikën e modelit epik të poezisë popullore shqiptare” (Mehmeti, 1990).

Mund të thuhet me të drejtë, sepse është e vërtetë që kjo vepër është konceptuar, strukturuar e sendërtuar sipas modelit të këngëve të epikës popullore legjendare dhe historike, në të cilat mbizotëron teknika e narracionit ose rrëfimit të ngjarjeve që është karakteristikë e këtyre dy lloje këngësh të folklorit të Veriut. Por, kur analizohet shprehësia e saj, shihet se mjetet që ka shfrytëzuar autori për sendërtimin poetik të saj e shëmbëlltyra e tyre del përtej këtij krahinorizmi, nëse do të mund ta quajmë kështu, dhe haset në të gjithë hapësirën e shtrirjes së këtij folklori.

Në vazhdim do të sjell disa shembuj për ta dëshmuar këtë gjë, sepse gjykimi se Fishta ka qenë i ndikuar vetëm nga folklori i Veriut, nuk mendoj se paraqet të vërtetën e plotë. Fishta është e vërtetë që ka qenë i ushqyer në gurrën e folklorit, por ky folklor nuk ishte as i veriut apo jugut, por ishte folklor shqiptar.

Sipas modelit të këtij folklori, ai, pra At Gjergj Fishta, pa asnjë hezitim modifikon fjalët, atje ku mendon se kjo gjë është në interes të shprehësisë, tamam ashtu siç bëhet kjo gjë edhe në krijimtarinë popullore. P.sh.: shkurton fjalët si në rastin:

„Kur tagānat (nëviz.imi-B.Z.) janë zatetë,
Fort shungllloi Vranina e shkretë.
Edhe u kpu’n t’dy për mjedisit
Si t’ki’n kënë dy krande lisit” (Fishta, *Lahuta e Malcis*, 1997, p. 51)

Modifikimi i trajtës së shumësit të fjalës *Jatagan* – *taganat* është i ngjashëm me atë të një kënge popullore të kohës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në të cilën thuhet:

Mic Sokoli, n’dy tagana
- Udhamarë! – m’i ka thanë nana,
- Lufto, bir, ti per Shipni
Mos i le tuqit me hi;
N’koftë nevoja, vi me ty (Albanologjik, 1978, p. 211)

Meqë krijimtaria e Fishtës, sidomos ajo me tematikë historike dhe kombëtare, qëndron në vazhden e hullisë së krijimtarisë folklorike, ai nuk e ka të vështirë të operojë me fjalën për t'i dhënë asaj funksion të theksuar shprehësie, për shkaqe të rimës, metrit apo ritmit, duke ndryshuar ndonjëherë edhe gjininë gramatikore të ndonjë emri. P.sh.:

„Bâjn kuvend Shqyphtarët n'mjet veti
E 'i fjalë t'madhe çuekan Mbreti:
Se jo veç qi Knjaz Nikollës
Nuk i lajn kurr pagë e t'dheta
Por se as Mbretit të Stambollës
S'duen me ia bâ mâ tungiatjeta, (Fishta, Lahuta e Malcis, 1997, p. 8)

Modifikime të këtilla, ku bëhet ndryshimi i gjinisë së emrit, për qëllime stilistike me funksion të forcimit të shprehësisë i hasim jo vetëm në folklorin e Veriut, por edhe në atë të Jugut. Le të marrim shembujt e dy këngëve të kësaj ane. E para, te kënga me titull *Medet për Vezir Alinë*, që i kushtohet Ali Pashë Tepelenës:

Medet për Vezir Alinë
që s'dëgjoi Boçarinë
të mblidhej me Bushatllinë
për të bërë Shqipërinë. (Mato, 2014)

Ndërsa e dyta është një këngë e mëvonshme, kushtuar Bilbilenjve, emër me të cilin njihej Çeta e Kurveleshit, e cila kishte vepruar gjatë 1850-1860, në krye të së cilës ishin Bilbil Sako dhe Bilbil Resuli, prej nga e ka marrë edhe emrin – Çeta e Bilbilenjve. Siç dihet, formimi i saj kishte ardhur si rrjedhojë e natyrshme e pakënaqësive të shtresave të gjera kundër reformave të Tanzimatit, të cilat ishin bërë në mesin e shek. XIX e që kishin rezultuar me gjoba të shumta për ato shtresa. Siç e dimë nga historia, 13 prej luftëtarëve të kësaj çete, përfshirë edhe dy kapedanët e saj, Bilbil Sako dhe Bilbil Resuli, ishin kapur nga autoritetet turke të kohës dhe ishin ekzekutuar me varje në litar.

„O Bilbil, ç'e bëre vetë,
Që kur preve hazinetë,
Që kur preve Stambollinë,
Me grusht e ndave florinë!” (Albanologjik, 1978, p. 125)

Siç shihet, në të tria rastet kemi të njëjtën mënyrë modifikimi: ndërrimin e gjinisë gramatikore të emrit. Stambolli, në rastin e parë dhe të tretë bëhet Stambolla, gjegjësisht Stambollinë, dhe Boçari e Bushatliu, në të dytin, bëhet Boçaria (Boçarinë) dhe Bushtallinë.

Pra, kemi ndryshimin e gjinisë së një emri të përveçem, që paraqet një lloj stileme e cila është në funksion të përforsimit të shprehësisë, pasi ky modifikim bëhet për qëllim të rimës.

Me këta shembuj dhe shumë të tjerë si këta që mund të hasen në “Lahutën e Malcis”, si dhe në të gjithë opusin krijuar të Gjergj Fishtës, mund të plotësohet konstatimi mbizotërues i studiuesve të ndryshëm të kësaj vepre se krijimtaria e këtij autori është e ndikuar nga folklori i Veriut.

Duke i marrë për bazë ngjashmëritë që solla më lart, atëherë mund të themi se kjo vepër, respektivisht poetika e saj, korrespondon, në masë të konsiderueshme, me poetikën e gjithë folklorit shqiptar dhe jo vetëm me atë të Veriut, siç është interpretuar deri tani.

Përfundim

Nga kjo që u tha deri tani, mund të përfundojmë se At Gjergj Fishta, si asnjë krijues tjetër, ka shfrytëzuar fondin leksikor të gjuhës së gjallë popullore për të realizuar dhe konkretizuar shprehësinë artistike duke mos iu përmbajtur asnjë norme apo rregull të caktuar, gjë që paraqet një lloj shmangie nga sistemi gjuhësor, por që ka meritën që kjo shmangie, pothuaj përherë, është me funksion të caktuar stilistik dhe estetik.

Një liri të tillë e ka shfrytëzuar përherë krijuesi anonim në letërsinë popullore të të gjithë hapësirës shqiptare e që, siç e dimë, muza fishtiane duket se ka pirë përherë në gurrën e saj.

Në sajë të kësaj lirie, ai nuk e ka problem që t’u bëjë modifikimin fjalëve të ndryshme dhe t’ua ndryshojë edhe format morfologjike, varësisht prej asaj që i duhet: për shkaqe metrike, të rimës apo për ndonjë arsye tjetër që, po ashtu, është element i rëndësishëm i stilit dhe i stilistikës.

Kjo liri e të shprehurit, siç e thashë, është shfrytëzuar maksimalisht nga ana e Fishtës dhe ka qenë me funksion stilistik dhe estetik. Ajo, asnjëherë nuk ka shkuar në dëm të shprehësisë, por gjithmonë ishte në funksion të forcimit të saj, gjë që paraqet një veçori tjetër që ia shton vlerën krijimtarisë së përgjithshme letrare të Gjergj Fishtës, e sidomos veprës së tij më voluminoze “Lahutës e Malcis”, të cilën, përkthyesi i saj në gjuhën angleze, Robert Elsie e ka vlerësuar si “një kryevepër, e cila zë vend në

radhën e eposeve të mëdha botërore” (Vataj, 2019), për të vazhduar më tej se ajo është „vepra e parë letrare shqiptare që i përket botës”. (Vataj, 2019)

Diçka të ngjashme për këtë vepër kishte thënë rreth një shekull më parë albanologu gjerman Maksimilian Lamberci (Maximilian Lambertz 1882 - 1963), i cili ka bërë dhe përkthimin e *Lahutës* në gjuhën gjermane. Ai, vajtimin e motrës së Avdi Hises, e ka krahasuar me vajtimin e Akilit për Patroklin dhe të Andromakës mbi Hektorin, ndërsa “*Lahutën e Malcis*” e ka vlerësuar për “kryevepër” (Vataj, 2019).

Megjithatë, siç e dimë të gjithë, Fishta është krijues me një histori të veçantë mbijetese, që nga fillimi e deri në ditët tona.

Ai dhe vepra e tij, në historinë e ekzistencës së vet, që prej fillimit e deri më sot, janë përplasur mes mohuesve dhe glorifikuesve të shumtë.

Duke i bërë një vështrim personalitetit të Adem Demaçit, Ukshin Hoti në librin e tij “Filozofia politike e çështjes shqiptare” ka thënë: “Për Demaçin mund të shkruhet gjithçka... Mund të jesh me të, përbri tij apo kundër tij, por nuk mund të jesh indiferent ndaj tij.” (Hoti, 1996, p. 176)

Duke pasur parasysh të vërtetën empirike të asaj që e thashë më lart, se mbijetesa e veprës së Fishtës ka frymuar mes përplasjeve të mohuesve dhe glorifikuesve të tij, si dhe nga fakti që, siç e thotë prof. Rexhep Qosja, Fishta kishte fatin e rëndë që “45 vite ishte i përjashtuar prej kujtesës së popullit të vet” (Qosja, 2010, p. 113), atëherë këtë vështrim mund ta përmbyll me një parafrazim të asaj thënieje të Ukshin Hotit për Demaçin.

Për Gjergj Fishtën është shkruar dhe mund të shkruhet edhe në të ardhmen gjithçka, por mund të thuhet vetëm një gjë: ai ishte krijuesi më me talent dhe më me frymëzim kombëtar. Kur e lexon veprën e tij në përgjithësi, por sidomos “*Lahutën e Malcis*”, mund ta pëlqesh ose mos ta pëlqesh për ndonjë element të saj, por indiferent nuk mund të qëndrosh përballë saj. Kjo, për arsyen e thjeshtë, sepse atë (jo të tërën dhe jo përherë) e shquan një shprehësi e rrallë. Rrënjët e sendërtimit të kësaj shprehësie duhen kërkuar jo vetëm në talentin e Fishtës, por edhe në faktin se dhuntia e kërshëria e tij krijuese ka lëshuar rrënjët për eksplorim poshtë në gurrën popullore për të përthithur sa më shumë nga palca e kombit dhe indi autokton i kulturës shqiptare, gjë që mund të haset te një numër i vogël krijuesish të traditës sonë, siç ishin: De Rada, Dara i Riu, Noli, Lasgushi e ndonjë tjetër, më pak i shquar për këtë aspekt.

Referencat

- Albanologjik, I. (1978). *Këngë Popullore të Rilindjes Kombëtare*. Prishinë: Instituti Albanologjik.
- Fishta, G. (1997). *Dramatika*. Prishtinë: Rilindja.
- Fishta, G. (1997). *Lahuta e Malcis*. Prishtinë: Rilindja.
- Fishta, G. (1997). *Lirika*. Prishtinë: Rilindja.
- Fishta, G. (1997). *Satirika*. Prishtinë: Rilindja.
- Gjeçaj, A. D. (2007). *Gjergj Fishta - Jeta dhe Vepra*. Shkodër: Botime Françeskane.
- Hoti, U. (1996). *Filozofia Politike e Çështjes Shqiptare*. Prishtinë: Partia e Unitetit Kombëtar.
- Islamaj, S. (2012). *Gjuha shqipe dhe stili*. Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Lloshi, X. (1988). *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*. Prishinë: Rilindja.
- Mato, A. (2014, Prill 14). *Revista Çamëria*. Gjetur Shtator 25, 2019, nga <http://revistacameria.blogspot.com/2014/04/agim-mato-udhetim-ne-pyjet-e-kengeve.html>
- Mehmeti, E. (1990, Nentor 15). *Lahuta e Malcise dhe eposi popullor. Fjala*, f. 5.
- Qosja, R. (2010). *Vepra III Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne* (Vëll. i III). Prishtinë: Instituti Albanologjik.
- Vataj, A. (2019, shtator 6). *Libri*. Gjetur në Kultplus: <https://www.kultplus.com/libri/lahuta-e-malcis-e-ate-gjergj-fishtes-vepra-e-pare-letrare-shqipe-qe-i-perket-botes/?fbclid=IwAR0ayDS3wNVsC9AxvFk4-OITKYww56huD8QixNdCC4d-PtG1koVkB1qAk0U>

Personazhi i femrës në librin “Prijësa e komiteve” të Sulejman Krasniqit

Besa Hoxha Beqiri, Prof. Ass. Dr.

Kolegji AAB

besa.hoxha-beqiri@aab-edu.net

Abstrakt

Në letërsinë shqiptare, femra, në të shumtën e rasteve, ka qenë vetëm personazh dytësor. Megjithatë, nuk kanë munguar edhe shkrimet ku personazhi i femrës portretizohet duke paraqitur botën komplekse, jo vetëm të saj, por edhe të shoqërisë shqiptare, në periudha të ndryshme të letërsisë. Sulejman Krasniqi është shkrimtar, i cili femrës i dha rol qendror në një pjesë të veprave të tij. Aq më tepër, ai arriti që të thellohet në disa aspekte të personalitetit të femrës shqiptare, nga ai i një femre të zakonshme të kësaj shoqërie, e deri te femra, lëvizëse e ndryshimeve të mëdha historike. Në librin “Prijësa e komiteve” Shota paraqitet me tërë kompleksitetin e një personazhi të kompletuar letrar, duke paraqitur, jo vetëm ndjeshmërinë femërore të saj, por edhe aspektin e një niveli të lartë të mençurisë dhe guximit. Nga ana tjetër, libri ngërthen edhe portretizime të personazheve të tjera femra, të moshave, kombësive dhe karaktereve të ndryshme. Një gjë e tillë, e begaton jo vetëm këtë vepër, por edhe letërsinë shqipe, me mozaikun e roleve të ndryshme të femrës në përpjekjet për një shoqëri më ndryshe, qoftë në aspektin e përkrahjes e përpjekjes për liri, qoftë në aspektin për robërim, apo edhe revoltën e papajtshmërisë së veprimit të instrumentit shtetëror në përcaktimin e fatit të një pjese të popullatës. Këto elemente shtojnë vlerën e personazheve femra në këtë vepër të Krasniqit.

Fjalë kyç: *femra, personazhi i femrës, portretizimi i femrës, personazhi, Shota*

Personazhi i femrës në letërsi

Femra shumë shpesh, ka qenë e injoruar si në jetën e përditshme ashtu edhe në letëri. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur vetëm në historinë e popullit shqiptar, por gjithashtu edhe te kombet, e më vonë edhe shtetet më të zhvilluara. Kjo ka lënë pasojë edhe në përfshirjen e personazhit të femrës

në letërsi. Duke qenë e injoruar dhe e papërfshirë në vëndimmarrje, qoftë personale, familjare apo edhe shtetërore, personazhi i femrës, në të shumtën e rasteve, paraqitet si dytësor apo si kompletim i personazhit mashkull në letësinë shqipe (me pak përjashtime).

Po ta kemi parasysh letërsinë e vjetër, duke i nisur nga fakti që letërsia në një pjesë të mirë ishte përkthim dhe përshtatje e veprave fetare, kur bëhet fjalë për letërsinë filobiblike, kemi paraqitjen e figurës së shën Mërisë. Nga ana tjetër, te bejtexhinjtë, me gjithë faktin se temë e huazur nga Kurani, te poema “Erveheja” dhe “Jusufi e Zelihaja” personazhi i femrës zë një hapsirë më të madhe, gjegjësisht është kryepersonazh te vepra e parë dhe përcaktuese e lëvizjes së ngjarjes, tek e dyta. Para këtyre veprave, tek humanistët shqiptar, personazhi i femrës është plotësim i përditshmërisë jetësore, plotësim i mozaikut.

Ndërkaq, letërisa e Romantizmit, nuk përqëndrohet shumë te portretizimi i femrës shqiptare, përveçse te shkrimtarët arbëreshë. “Ermira” e Santorit, ku personazhet kryesore në këtë dramë të parë në gjuhën shqipe, dorëshkrimin e së cilës e kemi, janë Emira dhe Kalina, dy vajza fshatare që dashurojnë të dyja Mirjanin (Elsie, f. 242); Lokja, Tringa dhe Zoga të poemës “Andrra e jetës” të Ndre Mjedës (Mjeda, 2010), ku fati i popullit shqiptar tregohet përmes tri femrave, (Shuteriqi Dh., 1959, f. 415), paraqesin një anë tjetër përbërëse të këtij populli. Ndërkaq, Serafina Topia (Rada, 1980) mbetet personazh jo i kompletuar nga ana e Jeronim de Radës. Tek vargjet e Naimit, përveç paraqitjes së bukurisë së femrës shqiptare, nuk preken aspektet e tjera të personazhit femër. Ndërkaq Sami Frashëri (Frashëri, 2013), edhe pse ka shkruar në gjuhën turke, ka arritur të realizojë tipizimin e femrës shqiptare të kohës së tij, apo Pashko Vasa, që gjithashtu, edhe pse në gjuhë të huaj, vuri në qendër femrën shqiptare (Vasa, N/A). Ashtu, edhe Çajupi, paraqet femrën si pjesë të shoqërisë me rol të vogël apo negativ (në aspektin e arritjes së qëllimeve, jo domosdoshmërisht të drejta, nëpërmjet bashkëshortëve, si te “Katërmëdhjetë vjeç dhëndër” (Çajupi, 2010), sipas motiveve të letërsisë gojore (Qosja, 2006, f. 126). Ndërkaq, Gjergj Fishta te “Lahuta e malësisë” (Fishta, 2000), me anë të figurës së Tringës, përveç bukurisë, paraqet edhe guximin e femrës shqiptare. *Për sa i përket stilit, fjalorit poetik dhe metrikës, “Mili e Hajdhia”, me tri botime, më 1891, 1900 dhe 1907, mund të quhet kryevepër e poezisë shqiptare të shekullit të njëzetë, kurse nga pikëpamja estetike, ndoshta vepra më e mirë e Skiroit, me gjithë zgjatjet dhe trajtimin sentimental të personazheve kryesore* (Elsie, f. 321), vepër kjo që gjithashtu portretizoi suksesshëm gruan arbëreshe. Migjeni, nga ana tjetër, ka arritur që fuqishëm të paraqesë figurën e gruas, si në prozë ashtu

edhe në lirikën e tij. Ky shkrimtar portretizoi femrën nën prizmin e ndjenjës, por edhe të shtrëngimeve kohore. Sipas Xheni Shehaj, *Migjeni nga ana tjetër, njohu dashurinë sublime, atë më të pastrën, më të shenjtën*. (Shehaj, 2017). Apo, nga ana tjetër, tek miti i pushtetit, në “Letërsia dhe vetësija historike” Bajram Krasniqi merr pikërisht melodramën “Vdekja e një mbretëreshë” të Rexhep Qosjes (Krasniqi B. , 1984, fv. 183-187)

Letërsia në vazhdim femrën e ka pjesë përbërëse të shtjellimit të ngjarjeve dhe jo aq personazh, rreth të cilit shtjellohet tematika e veprave të caktuara, apo ku spikatet roli i femrës në shoqëritë përkatëse. Shkrimtari, i cili femrën e vendosi në qendër të disa veprave është Sulejman Krasniqi. Aq më tepër, ai edhe titulloi veprat në bazë të personazheve kryesore të tyre. Është i veçantë fakti i shtrirjes së tematikave të ndryshme nga jeta dhe historia e popullit shqiptar, apo popujve të tjerë të shkrimtarët e njohur të letërsisë, në aq shumë shkrime, me kryepersonazhin nga pjesa më e ndjeshme e botës. Në novelën “Tri motra, tri histori” (Krasniqi S. , Tri motra, tri histori, 1972) dhe romanet “Prijësja e komitëve” (Krasniqi S. , Prijësja e komitëve, 1975), “Lindita” (Krasniqi S. , Lindita, 1977) dhe “Belbacakja” (Krasniqi S. , Belbacakja, 1992) Krasniqi, si kryepersonazh, jo vetëm që portretizoi femrën, në kohë dhe pozita të ndryshme jetësore, por edhe titulloi librat në bazë të tyre. Kjo e bënë këtë shkrimtar të veçantë edhe për këtë aspekt, përveç elementeve të tjera, të cilat i përfshinë në krijimtarinë e tij. Që nga Shotë Galica e historisë sonë kombëtare, e duke paraqitur gratë e thjeshta e deri te mësuesja, personazhet e këtyre veprave frymojnë ashtu siç plotëson jetën e popullit gruaja shqiptare. Mirëpo, edhe në veprat e tjera, kemi personazhe shumë të realizuara dhe interesante të femrës, si për shembull personazhi i Lokemadhes tek romani “Mic Sokoli” (Krasniqi S. , Mic Sokoli, 1979)

Mozaiku i personazhit femër

Sulejman Krasniqi, kur flet për personazhin e femrës në romanin “Prijësja e komitëve”, ndër të tjera, shkruan: *Mbarështrimi i atij romani më ndihmoi për së tepërmi në skalitjen e tipave dhe të prototipit të femrës shqiptare. Kisha punuar me daltë e me limë në gdhendjen dhe lëmimin e figurave. Tregova kujdes të madh në portretizimet shpirtërore e fizikë të personazheve të dorës së parë dhe epizodike duke ruajtur për secilin rëndësinë ideore dhe figurative*. (Krasniqi S. , Jetëshkrimi, 2011) Përkushtimi dhe puna e vetëdijshme me personazhet e veprave është shumë e dukshme në portretizimin e femrës, ndërsa në këtë roman u arrit

që të reflektohet dhe përpunohet përvoja e krijuar në novelat “Tri motra, tri histori”.

Në romanin “Prijësja e komitëve” Sulejman Krasniqi ka krijuar një mozaik të shumëllojshëm të personazhit të femrës, jo vetëm në aspektin e formësimit të tyre, por gjithashtu nga ai i përfshirjes së personazhit jo vetëm shqiptar. Në këtë roman shkrimtari kishte skalitur prototipin e femrës shqiptare, gjë që e vazhdon me shumë mjeshtëri edhe në veprat e tjera, qoftë kur femra na paraqitet si personazh kryesor, qoftë atëherë kur e kemi dytësor. Me llojllojshmërinë e figurës së femrës, shkrimtari paraqet kompleksitetin e kësaj bote që nga ndjenja e fortë e amësisë (ndër të tjera edhe me personazhet e koloneve serbe të detyruara të shpërngulen në trojet e Kosovës dhe vrasjes së fëmijëve të tyre nga vetë serbët) e deri te femra udhëheqëse e një lëvizjeje, megjithë të jetuarit në një botë patriarkale, ku burrat nuk mund ta pranojnë të udhëhiqen nga ato. Kompleksiteti i formësimit të personazheve nuk është bërë me anë të portretizimeve direkte, por nëpërmjet përjetimeve dhe ngjarjeve të ndryshme. Kjo, personazhin e femrës e nge në një nivel tjetër, sepse i jep mundësi lexuesit që të krijojë portretin ashtu siç e parafytyron vetë.

Kam për prijëse një trimëresh

Prin, lufton si sokoleshë. (Krasniqi S. , Prijësja e komitëve, 1975, f. 338)

Vargjet e këngës së Qorr Agushit, para ekzekutimit, përshkruajnë femrën, udhëheqëse të patrembur të luftëtarëve të regjur Shotë Galicën, e cila megjithëse trime, e mençur e stratege e shquar është e papranuar nga një numër burrash. Përveç faktit të refuzimit, që në fillim, prezencën e një femre mes komitësh (femra e parë), të paturit atë si prijëse, merrej si fyerje nga një pjesë e madhe e burrave. Trajtimi i femrës si jo të barabartë, apo person të paaftë për ballafaqimin me ashpërsinë, si dhe si të pazonjën për të luftuar për vete dhe popullin e saj, vihet në shprehje, posaçërisht nëpërmjet veprimeve dhe fjalëve të Ukë Gunës. Femra, sipas tij, është *për të bërë fëmijë, për të larë pelena* (54). Me këtë Krasniqi ballafaqon lexuesin me mospajtimin e një pjese të botës mashkullore rreth mundësisë së udhëheqjes së tyre nga femrat, apo edhe vetë barabarësisë së aftësive të tyre. Shkrimtari shkon edhe më larg kur në roman, nëpërmjet kujtimeve të Shotës, shkruan se një qasje e tillë ndaj gjinisë më të ndjeshme ishte mbjellur me kohë, prandaj ishte rezultat i të ushqyerit të botës mashkullore me një bindje për vendin e femrës. Shkrimtari, përmes mendimeve të kryepersonazhit të veprës, ve në pah se edhe në rapsodi, ajo trajtohet si mendjelehtë dhe djallëzore, sepse hero i këngës *kishte rënë viktimë e*

djallëzive dhe shpirtit të lig të femrave, që e joshte mashkullin në punë të pahijshme, pastaj e braktiste se donte një tjetër. (Krasniqi, 1975, f. 120) Kjo tregon një qasje nënçmuese ndaj saj, pavarësisht aftësisë apo guximit. Me një trajtim të tillë Shota, në këtë libër, ballafaqohet si atëherë kur do të bëhet rapsode, ashtu edhe kur është bareshë, si luftëtare ashtu edhe si prijëse e komitëve sepse *trimëreshë, e ka kryet plot mend, por është femër!...* (54)

Sulejman Krasniqi në romanin “Prijësa e komitëve” ka arritur që të vendos një paralele mes trajtimeve dhe qëndrimeve shoqërore ndaj femrës dhe njëkohësisht nëpërmjet portretizimit të personazhit femër të paraqes thyerjen e paragjyqimeve. Jo vetëm nëpërmjet personazhit të Shotës, por edhe me një varg të personazheve të tjera, në këtë roman, përfshirë edhe femrën serbe, shkrimtari na e paraqet atë të guximshme, por njëkohësisht të ndjeshme; të nënshtuar e të trembur deri në momente të caktuara, por edhe luftarake për vendin e saj në shoqëri; edhe pse me hapësirë veprimi shumë të kufizuar, të zgjuar dhe të gjindshme, plot ide në momente të caktuara, nga ana tjetër shënjestër të armikut për shkak të mundësisë së lëndueshmërisë, jo vetëm personale, por edhe të popullit, gjegjësisht nderit të tij në përgjithësi.

Shotë Galica – gruaja, simbol i guximit dhe trimërisë

Një nga personazhet më të formësuara të krijimtarisë së Sulejman Krasniqit është personazhi i Shotë Galicës. *Grotesku shihet në vepër si tipar veçues i mendimit artistik në folklor, si formë e individualizimit të personazheve, si opozicion letrar-estetik me të madhërishten heroike, si botëkuptim artistik mbi kohën dhe hapësirën* (Sinani, Proces letrar: Kërkime dhe vlerësime, 2010, f. 35). Te ky personazh shkrimtari ka arritur groteskun, që përmes një figure të njohur historike, t’i jep botës së shkrimit personazhin e kompletuar të gruas shqiptare, duke ndërthurur, jo vetëm ndjeshmërinë femërore, por edhe karakterin e fortë të saj, trimërinë dhe sakrificën. Elementi i vetëm i pareaizuar është dashuria amnore, që nuk është trajtuar direkt ndaj fëmijës, por që nuk mungon në shprehjen e kësaj ndjenje ndaj fëmijëve të tjerë, e posaçërisht ndaj vajzave, të cilat janë shtresë shumë e rrezikuar, për shkak të robërimit të tyre dhe tentimeve të dhunimit. Shkrimtari, bënë edhe një hap më tutje, duke ia mveshur përgjegjësinë e marrë përsipër nga kryepersonazhi ndaj vajzave, të cilat bëhen pjesë e jetës komite për arsye të ndryshme. Kështu, Krasniqi arrin që të kompletojë Shotën edhe me një element, i cili i mungonte këtij personazhi historik.

Krasniqi na jep një personazh njerëzor, jo vetëm me elementet pozitive por edhe me dobësitë. Kështu Shota, edhe pse një grua e guximshme, e cila është e patrembur edhe ndaj situatave më të rrezikshme, ka momente që, megjithë forcën, natyra njerëzore, posaçërisht ndjeshmëria femërore manifestohet në situata të caktuara, momente këto kur edhe vetë nuk ndihej mirë ... *duke mallkuar veten se ato ditë lotët po e tradhëtonin.* (Krasniqi S. , Prijësa e komitëve, 1975, f. 116)

Veshja e karakteristikave dhe formimi i një personazhi kompleks te figura e Shotës, jo vetëm nga aspekti luftarak, duke e paraqitur si trime dhe stratege të pa të metë, ngërthen edhe një botë interesante të një niveli të lartë intelektual, duke menduar rreth aspekteve të ndryshme filozofike, e posaçërisht aspektit të pozitës së gruas në shoqëri. Nga ana tjetër, paraqitet edhe personazh kureshtar, e cila, *Sa herë i bënte pyetje të shumta Mentorit, Shota skuqej, se i dukej vetja si ata fëmijët kureshtar që, me të parë një send, fillojnë psetë pa mbarim.* (116) Është interesant portretizimi i tillë i kryepersonazhit, duke njohur psikikin e njeriut, ku personat me ndikim dhe pozitë, pothuajse gjithnjë, përpiqen të mbajnë qëndrim dhe të paraqiten si të gjithëdijshëm. Kështu, këtu paraqitet bota jo e përsosur dhe e mangët që ka personi, sado që të jetë dhënë me elemente të forta të karakterit.

Shota portretizohet nga Krasniqi si një personalitet kompleks, por edhe që sjellë risi dhe është hapëse e një rruge dhe rrugëtimi të ri të femrës shqiptare (nënës, gruas dhe vajzës shqiptare). Që në fëmijëri, ajo ka ëndrra të mëdha dhe të ndryshme nga ato të moshatareve të saj. Në rini *Ju mbush mendja top se edhe si femër nuk i mungonte asgjësendi të mbronte veten dhe të bëhej si Muji, Halili apo Hasimja.* (122) Shkrimtari është kujdesur që një personalitet i tillë mos të formësohet pa bazë dhe elemente që e shtyejnë në këtë formësim. Kështu, babai i Shotës, përkundër rregullave të rrepta të popullatës shqiptare të kohës, shtien me pushkë edhe pse i lind vajzë, si dhe merr me vete Shotën, që në fëmijëri, në oda, gjë që nuk ndodhte me vajzat, ku pati mundësi që të dëgjojë mbi luftërat e trimëritë, jo vetëm të kohës, por gjithashtu edhe nga legjendat që tregoheshin e këndohej për to. Me këtë, në vepër, arrihet që karakteri dhe qëndrimi i kryepersonazhit të plotësohet me elementet e formimit (me kthimin në retrospektivë me anë të kujtimeve/mendimeve të Shotës), gjë që nuk le hapsirë për qëndrime të pambështetura.

Nga ana tjetër, Shota nuk ishte si të tjerat, të cilat *As guxonin të hapnin gojën, sepse sëpata e madhe ngrihej kërcnueshëm, e e shkreta jetë është e dhembshur; më mirë pranonin të jetonin kokëulur, sesa të përfytyronin varrin...* (123). Kështu, personalitetin e Shotës shkrimtari e ve në pah edhe duke paraqitur, krahas saj, personalitetin e grave të tjera. Deri

sa grat nënshtroheshin për shkak të frikës nga ajo se çfarë mund t’iu ndodh, kemi kryepersonazhin, e cila pa frikë ballafaqohet me vdekjen, pothuajse në çdo veprim të saj. Por, gjithashtu ballafaqohet edhe me martesën, me të cilën përkundër faktit që e dinte nga përvoja e shoqeve se, *fillonte kalvari i ndrydhjeve të dëshirave, fillonte zvarritja përpara çdo mashkulli në shtëpinë e burrit, qofshin ata edhe gjashtë – shtatë vjeç* (123), për të do të ishte ndryshe. Ajo, jo vetëm që nuk u zvarrit para asnjë mashkulli, por arriti edhe t’i udhëheq ata. Kështu Krasniqi arrinë, që përmes kontrastit, të fuqizojë karakterin e Shotës.

Ajo kurrë nuk ishte kthyer pa arritur cakun e pikësnyuar. (33) Shota, personazh i vendosur, e patrembur dhe këmbëngulëse, shpesh herë, në roman, tregohet më e shkathët se bashkëlufëtëtarët e saj. Me këto karakteristika shkrimtari përmbush personalitetin, pasi që po të mos ishte vendosmëria e Shotës, as që do të arrinte të bëhej pjesë e komitës, e aq më pak prijëse e tyre. Duke jetuar në një rreth patriarkal, ku vajzat kishin ëndërr vetëm martesën, gratë përmbushjen e detyrimit ndaj burrave e nënat rritjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve, karakteri domosdoshmërisht, përveç elementeve shtesë familjare, duhej të paraqitej si pjesë e fortë e rrjedhës së veprimeve dhe ngjarjeve në vepër.

Personazhi i gruas shqiptare dhe atyre të kombësive tjera

Romani “Prijësa e komiteve” është një mozaik i personazhit të gruas, jo vetëm asaj shqiptare. Edhe pse *nuk do të thotë se nuk mund të shkruhen edhe vepra, në të cilat mungojnë personazhet nacionalisht të emërtuara dhe ngjarjet ambientalisht të lokalizuara*, (Qosja R. , 1973, f. 79), me gjithë përjetimet personale dhe rrethanat historike, në këtë roman, nuk ndodhë një gjë e tillë. Kjo, edhe në një rrafsh tjetër, tregon profesionalizmin dhe përkushtimin në shkrimet e Krasniqit.

Një nga personazhet të realizuara mjeshtërisht është personazhi i Merushë Mështeknës, “e çartura e Drenicës” (Krasniqi S. , Prijësa e komitëve, 1975, f. 38), grua, jo vetëm me karakter të fortë, por edhe shembull për të tjerët, arsyë kjo, e cila bënte që *e tërë Tërpeza të krenohej me të, edhe pse ishte muhaxhire në atë fshat* (38). Me këtë kontrast, të krenuarit me një të ardhur, edhe pse nofka dhe karakteri i saj paraqitet i rrezikshëm, për një grua që *mund edhe t’i vriste për fyerjen edhe më të vogël* (38), qysh në fillim të romanit na ballafaqon me një personazh me aq kundërshti. Kjo sjell tek dilema e karakterit të këtij personazhi dhe kontradikta e të pëlqyerit nga të tjerët. Në roman paraqitet ndikimi i rrethanave jetësore në personatitetin, egërsinë, guximin dhe

këmbëngulësinë e Merushës. Vdekja e të shoqit (vlarë pas 2 muajsh martesë), si dhe zakonet, bëjnë që shkrimtari të martojë këtë personazh për herë të dytë me një burrë me fëmijë. Tradhëtia e thjeshtit, Safetit, arsye e vrasjes së vetë babait të tij dhe djemëve të Merushës (shpëton vetëm djalë e vogël dhe të bijën), e bën këtë të fundit të hakmerret (vret vrasësin) dhe largohet që të mund të mbijetojë bashkë me fëmijët e shpëtuar. Kjo e vështirëson jetën e Merushës dhe e vendos atë përballë shumë sprovave. Pas aftësimit për jetë të fëmijëve të saj të shpëtuar, edhe ajo angazhohet për të mirën e përgjithshme. Ajo depërton aty ku nuk mund të kryejnë punë meshkujt, kontaktin me femrat e tjera, si shqiptare ashtu edhe serbe.

Nga ana tjetër, edhe nënat serbe, kolone të shpërngulura me detyrim në Kosovë, shkrimtari i krahason në disa aspekte me femrën shqiptare. Kështu, Plamenka, një kolone serbe, së cilës përveç njërit djalë të shpëtuar, që në fillim nuk e dinte ku e kishte, fëmijët e tjerë ia kishin vlarë, krahasohet me Merushën, duke mos vënë paralele direkte të konkretizuar, por shkruan: *Ndoshta hallet dhe brengat kishin lënë gjurmë të përbashkëta në ftyrat e dy grave...*(169). Duke mos përshkruar imtësisht përjetimet e dy grave, shkrimtari paraqet dhembjen e nënës për fëmijën, dhembje kjo që nuk ndryshon në varësi të kombësisë.

Motra e Plamenkës, Angja Serbijanka, shpëtimtare e Shotës, megjithë rrezikimit që bënë për të ndihmuar popullatën dhe prijësen e komitëve, sërish për të flitet me nënçmim nga komiti Bejtë Bajçinovci, për shkak të përkatësisë së saj kombëtare. Në mbrojtje të saj, Shota thotë: *Është njeri, është nënë e djalit të vlarë, Bejtë për të vazhduar se atë çdo gjë e ndan nga gjakatarët, gjithçka e bashkon me ne dhe me luftën tonë* (115). Interesant është fakti i njohjes së dhembjes dhe vlerave të personave, që shumë lehtë mund të konsiderohen të taborit armik, edhe pse nuk lë pa bërë pjesë të kolazhit të personazheve edhe atë të bashkëpunëtores me serbët, Dushankën apo “ciganes” së nënçmuar. Duke u nisur nga fakti i luftës që zhvillohej, nga krimet që bëheshin ndaj shqiptarëve, sërish arrihet që, personazhet e Sulejman Krasniqit mos të krijohen si persona bardhë e zi, por të veshur me vlara që kanë edhe mangësitë e tyre.

Përfundime

Për brezin e shkrimtarëve të viteve '70 Shaban Sinani thotë: *Romanet e kësaj periudhe, përkundër heroizmit triumfalist që ishte trashëguar deri atëherë në prozën kushtuar luftës, patën sukses sepse pasuruan galerinë e personazheve me vlara njerëzore të përgjithshme, futën dilemën, e*

vendosën luftën në një largësi të domosdoshme nga subjekti krijues (Sinani, 2011, f. 113).

Në romanin “Prijësa e komiteve” femra e Krasniqit zë vendin e saj në shoqërinë shqiptare. Ajo, jo vetëm që paraqitet e denjë të qëndrojë pranë mashkullit, por me raste, edhe akuzon veprimet negative apo të pamenduara të meshkujve, si dhe tejkalon herë pas here, gatishmërinë për sakrificë dhe rrezikshmëri për hir të mbrojtjes së fëmijëve të saj, apo hakmarrjes për ta.

Tek “Prijësa e komiteve” hasim kontrastin e personazhit të femrës, në njërën anë Shotën, trimëreshë dhe të paluhatur në arritjen e përmbushjes së aktiviteteve, ashtu si dhe burrat/meshkujt; gratë si: Merushë Mështekna, Afërdita, Selvija etj. të cilat, edhe përkundër pikëpamjeve shoqërore, luftojnë e përpiqen maksimalisht për të mirën e përgjithshme, si dhe kolonet serbe, si Angja Serbianka me të motrat dhe të bijën Zorkën të cilat, nga dhembja e përjetuar për shkak të vuajtjeve të shkatkuara nga bashkëkombasit, luftojnë syptatrembur kundër së keqes dhe përpiqen në pengimin e malltretimit/masakrimit të njerëzve të pafajshëm e deri te femra si Dushanka, femër e cila shfrytëzonte të gjitha mjetet për zënjën e luftëtarëve nga forcat serbe (si Emrushin e dashuruar në te).

Kështu, Sulejman Krasniqi ka arritur që të kombinojë aspekte të ndryshme të natyrës femërore, që nga ato të nënshtruarat dhe të bindurat ndaj botës mashkullore, qoftë babait apo burrit; të frikësuarat nga të papriturat apo edhe armiku; spiunet që punojnë punët më të ndyta për përmbushjen e bindjeve personale, apo ato që rrezikojnë për të ndihmuar mbrojtjen e njerëzve të dashur e deri te femrat syptatrembur si Shotë Galica, e cila gjithnjë përpiqet dhe arrin që të barazohet me të tjerët, e dukshëm edhe t’i tejkalojë ata, duke u treguar edhe më e aftë, për shkak të zgjuarsisë e guximit, por edhe shfrytëzimit të qasjes më të lehtë tek e tërë popullata (përfshirë gratë e vajzat).

Duhet të ceket se brenda këtij romani është arritur, që me mjeshtëri të lartë artistike dhe ideore, të shtjellohet bota komplekse e femrës, nga një shkrimtar mashkull, në një situatë të rëndë historike. Kështu, personazhi është paraqitur me tërë kompleksitetin e vetë shpirtëror, moral dhe veprues. Me pak përjashtime, ku bëhet edhe përshkrimi i ndonjë tipari fizik, edhe pse një gjë e tillë nuk është e shtrirë në këtë roman, lexuesi as që ndjen nevojën për këtë, sepse ritmi i ngjarjeve, veshur nga personalitetet dhe bota e brendshme e personazheve, përmbush aspektin psikik të tyre dhe plotëson zbrazëtinë eventuale vizuale. Kjo pasuron mundësinë e imagjinatës së vetë lexuesit.

Përfundimisht, romani “Prijësja e komitëve” i Sulejman Krasniqit është një galeri interesante, e larmishme dhe shumë e realizuar e personazheve femra. Lloj-llojshmëria e karaktereve dhe personaliteteve të tyre reflektohet nga kompleksiteti i vetë natyrës femërore dhe ndikimit të rrethanave jetësore në formësimin e personalitetit të saj. Natyrisht, kompleksiteti paraqitet dukshëm në varshmëri me botën mashkullore. Kështu, Krasniqi ka arritur që, jo vetëm në këtë roman, por edhe në shkrimet e tjera të tij, që letërsisë shqiptare t’i dhurojë personazhe shumë të realizuara, që i takojnë gjysmës më të ndjeshme të njerëzimit, e njëkohësisht të kombitë tonë. Vlera edhe më e madhe qëndron në faktin e gërshetimit edhe të femrave të kombësive tjera (sebe e rome) në kohën kur shkrimtari kishte probleme personale me sistemin shtetëror serb. Tejkalimi i një përplasjeje me realizimin e personazheve serbe aq pozitive dhe të këndëshme për lexuesin, edhe një herë tregon për madhështinë e një pende.

Për personazhin e gruas janë shkruar edhe monografi (Kryeziu, 1988), por mbetet ende mjaft për të studiuar. Një ndër burimet më të çmuara të portretizimit të femrës së niveleve dhe situatave të ndryshme është krijimtaria e Sulejman Krasniqit.

Referencat

- Çajupi, A. Z. (2010). *14 vjeç dhëndër*. Tiranë: Reklama.
- Elsie, R. (a.d.). *Historia e letërsisë shqiptare*.
- Fishta, G. (2000). *Lahuta e Malcis*. Tiranë: Toena.
- Frashëri, S. (2013). *Besa*. Prishtinë: Piramida.
- Krasniqi, B. (1984). *Letërsia dhe vetëdija historike*. Prishtinë: Rilindja.
- Krasniqi, S. (1972). *Tri motra, tri histori*. Tiranë: Naim Frashëri.
- Krasniqi, S. (1975). *Prijësja e komitëve*. Tiranë: Naim Frashëri.
- Krasniqi, S. (1975). *Prijësja e komitëve*. Tiranë: Naim Frashëri.
- Krasniqi, S. (1977). *Lindita*. Tiranë: Naim Frashëri.
- Krasniqi, S. (1979). *Mic Sokoli*. Tiranë: Naim Frashëri.
- Krasniqi, S. (1992). *Belbacakja*. Tiranë.
- Krasniqi, S. (2011). *Jetëshkrimi*. Tiranë: Neraida.
- Kryeziu, R. (1988). *Personazhi i gruas në letërsinë shqipe mes dy luftërash*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Mjeda, N. (2010). *Juvenilija*. Tiranë: Reklama.
- Qosja, R. (1973). *Panteoni i rralluar*. Prishtinë: Rilindja.
- Qosja, R. (2006). *Prej letërsisë romantike deri te letërsia moderne*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- Rada, J. d. (1980). *Serafina Topia*. Prishtinë: Rilindja.

- Shehaj, X. (2017, shtator 5). *Moderniteti i Migjenit: Figura e femrës*. Gjetur në Galaktika poetike Atunis: <https://atunispoetry.com/2017/09/05/moderniteti-i-migjenit-figura-e-femres-nga-xheni-shehaj/>
- Shuteriqi Dh., D. M. (1959). *Historia e letërsisë shqipe II*. Tiranë: Mihal Duri.
- Sinani, S. (2010). *Proces letrar: Kërkime dhe vlerësime*. Tiranë: Naimi.
- Sinani, S. (2011). *Kritika e historishkrimit të letërsisë*. Tiranë: Qendra për Studime Albanologjike.
- Vasa, P. (N/A). *Bardha e Temalit*. N/A: Falcon.

The Role of the Teacher in Developing Communicative Skills Among Young Learners of English as a Foreign Language

Blerim Sherifi, MA

SEEU University

blerimsherifi99@gmail.com

Abstract

